

# Kumbona e së Diellës



Shenjtorja e Zonjes Fatima, Portugali

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT  
Nr.1/2, Janar - Shkurt 2014

# A KA PËRPLASJE MES BIBLËS DHE SHKENCËS?!

## Si e përshkruanin Shumerët krijimin e njeriut!

(Pjesë nga libri, Planeti i 12- të)

- Pjesa 16 -

Autori, shprehet se:

“libri në fjalë, nuk ka asnjë kundërshtim midis Biblës dhe Evolucionit.

“Libri i qëndron kohës”, thotë autori, dhe “besoj unë, se na tregon të vërtetën për vet zanafillën tonë- dhe që,  
NE NUK JEMI VETEM.”

**ZECHARIA SITCHIN**

**Planeti i 12 -të**

**Tiranë, 2009.**

### KRIJIMI I NJERIUT

Si u përfundua krijimi i njeriut?

Teksti “Kur Zotat si njerëz” përmban një përshkrim qëllimi i të cilit ish të shpjegonte pse “gjaku” i një Zoti duhej ngjizur në “argjilë”. Elementi “hyjnor” i kërkuar s'ish thjesht gjaku që pikon i një Zoti, por diçka më themelore dhe e qëndrueshme.

Zoti që zgjidhej, na thuhet, kish TE.E.MA- një term të cilin autoritete kryesore për tekstin (Ë.G.Lambert-i e A.R.millard-i të universitetit të Oksfordit) e përkthejnë si “personalitet”. Por termi i lashtë është shumë më i përcaktuar; fjalë për fjalë ai ka kuptimin “ajo që strehon që lidhë kujtesën”. Më tej, i njëjti term shfaqet në versionin Akadisht si etemu, e përkthyer si “shpirt”.

Në të dy shembujt po merremi me atë “diçka” në gjakun e Zotit e cila ishte streha e cilësive të tij. Të gjitha këto, na duket e sigurte, s'janë veçse mënyra të tërthorta për të thënë se ajo që po kërkonte Ea, kur e vuri gjakun e zotit përmes një sërë “banjash dëlirjeje”, ishin gjenet e Zotit.

Qëllimi i ngjizjes plotësisht të këtij elementi hyjnor me elementin tokësor shprehej gjithashtu qartë: Në argjilën, zot e Njeri do lidhen, në një të vetëm sjellë së bashku; Që gjer në fund të ditëve Mishi e Fryma që në Zot janë pjekur- që fryma në farë-gjaku të lidhet; Si Shenjë të saj jetën do ta shpallë. Që kjo të mos harrohet, “Fryma” në farë-gjaku u lidhtë.

Këto janë thënie të mëdha, të kuptuara pak nga studiuesit. Teksti përcakton se gjaku i Zotit ngjizej në argjilë që t'i lidhte Zot e njeri gjenetikisht “gjer në fund të ditëve” kështu që si mishi (“shëmbëlltyra”) dhe fryma (“ngjashmëria”) e zotave do të bëhej gjurmë e ngulitur mbi njeriun në një farefis gjaku që s'mund ti shkëputej kurrë më.

Epika e Gilgameshit” na njofton se kur Zotat vendosen t'i bënin një kopje Gilgameshit pjesërisht hyjnor, Perëndesha nënë ngjizi “argjilë” me “esencën” e zot Ninurta-s. Më pas në tekst, fuqia e madhe e Enkuidu-t i vishej pasjes brenda tij të “esencës së Anu-t”, një element që ai e fitoi përmes ninurtas, nipit të Anut. Termi Akad kisir na paraqet një “esencë” një “koncentrat” që e kishin zotat e qiejve.E.Ebeling-u i përmbledhi përpjekjet për të kuptuar domethënien e saktë të kisir-it, duke thënë se si “Esencë, apo njëfarë nuance e termit, ajo mund të përdorej mirë për hyjni e po ashtu për raketa nga qielli”. Edhe E.A.Speiser-i pajtohej se termi nënkuptonte “diçka që zbriste nga qielli”.

Kishte edhe kuptimin, shkruante ai, “që mund të dalë në pah me përdorimin e termit në tekste me përmbajtje mjekësore”.

U kthjem në një fjalë përkthimi të thjeshtë, të vetëm:gjen.



|                                                           |    |
|-----------------------------------------------------------|----|
| Papa Fraçesko<br>MËSIMET KISHTARE                         | 4  |
| Mons. Angelo Massafra<br>DEKLARATA-LUFTA NDAJ KRIMIT      | 6  |
| Don Prend Kola<br>PREDIKIMI I FJALËS SE ZOTIT - HOMELIA   | 7  |
| Don Nosh Gjollaj<br>FAKTORËT QË E SHKATËRROJNË FAMILJEN   | 10 |
| -<br>ZOJA FATIMA - MREKULLIBËRËSJA                        | 13 |
| Prof. dr. Uran Asllani<br>KLERIKËT DHE KONFERENCA E PAQES | 16 |
| Frano Kulli<br>PELEGRINAZH NË KUKLIN E MJEDËS             | 20 |
| Alma Mile<br>PLURALIZMI I BESIMIT                         | 22 |
| Tomë Mrijaj<br>MARIE SHLLAKU                              | 26 |
| Dom Nikë Ukgjini<br>AUSTRO-HUNGARIA DHE KLERI KATOLIK     | 29 |
| D.N.<br>KTHEU O ZOJA E KËSHILLIT TE MIRË                  | 31 |
| VITRINA E LIBRIT                                          | 32 |

## KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 1/2 (460-461) Janar - Shkurt 2014

Revistë  
Fetaro-Kulturore  
Drejtues  
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia  
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)  
Atë Mario Imperatori S.I.  
Dom Gjovalin Sukaj  
Loreta Tomaj

Adresa:  
Arqipeshkvia Shkodër  
Sheshi Gjon Pali II  
Tel. 0222-42764  
Fax. 0222-43673  
e-mail: n\_ukgjini@yahoo.it  
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



## PAPA FRANÇESKO: MËSIMET KISHTARE TË MOS SHNDËRROHEN NË IDEOLOGJI!

Të mos e shndërrojmë doktrinën e Kishës në ideologji, ose në teori abstrakte, por ta përdorim gjithnjë në shërbim të besimtarëve. Në audiencën me pjesëmarrësit në asamblenë e përgjithshme të Kongregatës për Doktrinën e Fesë, Papa Françesku kërkoi që kriteret e fesë të udhëheqin gjithnjë fjalët e praktikën e Kishës. Kur feja shkëlqen për thjeshtësinë e saj, tha Ati i Shenjtë, edhe në shoqëri, Zoti është i pranishëm me gjithë forcën e Tij tërheqëse. Që kjo të ndodhë, vijoi Papa, nuk duhet ta kuptojmë doktrinën e krishterë si ideologji, ose ta reduktojmë në një sërë teorish abstrakte. “Në të vërtetë, doktrina ka si qëllim të vetëm t’i shërbejë jetës së Popullit të Zotit, duke i siguruar fesë baza të shëndosha. Vërtet, është i madh tundimi për t’i paraqitur si tonat dhuratat e shëlbimit, që vijnë prej Zotit, për t’ua nënshtuar – ndoshta, edhe me qëllim të mirë - këndvështrimeve e shpirtit të kësaj bote. E ky është sigurisht, një tundim që përsëritet vazhdimisht”.

Papa Françesku e falënderoi Kongregatën për Doktrinën e Fesë për trajtimin e disa çështjeve të rënda, siç është ajo e shpërdorimit seksual të të miturve. Në këtë fushë, lajmëroi risi: “Mendoni për të mirën e fëmijëve e të rinjve, që në bashkësinë e krishterë duhet të mbrohen e të përkrahen në rritjen e tyre njerëzore e shpirtërore. Po studiohet mundësia e lidhjes së Dikasterit tuaj me Komisionin e veçantë për Mbrojtjen e Fëmijëve, themeluar tashmë, që do të doja të ishte shembull për të gjithë ata, të cilët duan të punojnë për të mirën e fëmijëve”.

Ati i Shenjtë nuk mungoi të fliste për temën e Asamblesë, përqendruar në marrëdhëniet ndërmjet fesë dhe Sakramentit të martesës: “Kemi të bëjmë me një reflektim me rëndësi të madhe. Ai është në vazhden e fesës, që e pati formuluar qysh Benedikti XVI, rreth nevojës për t’i shqyrtuar deri në fund marrëdhëniet ndërmjet fesë personale dhe kremtimit të Sakramentit të martesës, sidomos në kuadrin e ndryshuar kulturor”. Papa kujtoi se detyra e Kongregatës për të mbrojtur integritetin e fesë është mjaft delikate, prandaj duhet realizuar në bashkëpunim me barinj të vendit e me Komisionet



doktrinale të Konferencave të ndryshme Ipeshkvnore: “Puna juaj përpiket të ketë parasysh edhe kërkesat e dialogut konstruktiv, plot respekt e durim, me Autorët. Nëse e vërteta ka nevojë për besnikërinë, kjo e fundit shtohet për hir të dashurisë e ndihmës vëllazërore ndaj atij, që duhet t’i sqarojë, apo t’i maturojë bindjet e veta”.

Dikasteri për Doktrinën e Fesë, u tha Papa Françesku pjesëmarrësve të asamblesë së përgjithshme, dallohet për frymën e kolegjalitetit e të dialogut. Kjo frymë duhet bërë metodë pune brenda Kishës, në çdo nivel: “Jam i sigurt se sa më shumë kolegjaliteti të jetë tipar karakteristik i punës, aq më shumë do të shkëlqejë para botës drita e fesë sonë. Në krejt shërbimin tuaj, uroj ta ruani gjithnjë ndjenjën e thellë të gëzimit, të gëzimit të fesë, që e ka burimin e pashtershëm në Zotin tonë, Jezu Krishtin”.

Nëse humbasim kuptimin e Zotit, edhe mëkati më i shëmtuar duket vogëlsi/“Kur mungon prania e Zotit ndërmjet njerëzve, humbet kuptimi i mëkatit, e kështu mund të ndodhë t’i bëjmë të tjerët të paguajnë çmimin e mediokritetit tonë të krishterë. E pohoi Papa Françesku në homelinë e Meshës, kremtuar në Shtëpinë e Shën Martës. T’i lypim Zotit hirin të mos na meket kurrë prania e Mbretërisë së Tij, ishte porosia kryesore e Papës. Një mëkat i rëndë, siç është për shembull shkelja e kurorës, shikohet thjesht si problem për t’u zgjidhur. Këtë rrugë, treguar në Leximin e parë të Liturgjisë së sotme zgjedh Davidi mbret. E Papa e përdori si pasqyrë, për të vënë para saj ndërgjegjen e gjithë të

krishterëve. Davidi joshet nga Betsabeja, gruaja e Urisë, gjeneral i tij. E merr gruan, ndërsa të shoqin e nis në vijën e parë të betejës, që të gjejë vdekjen. E vërtet, Uria vritet. E Davidi mëkaton rëndë, duke kryer, kështu, një vrasje me paramendim. Bën pra, një mëkat mortar, por nuk e ndjen fare se ka mëkatuar, sqaroi Papa, e as që i shkon nëpër mend të lypë falje. Çka e shqetëson, është si ta zgjidhë këtë problem kaq të mprehtë, pa i hyrë ferrë në këmbë: “Të gjithëve mund të na ndodhë kjo gjë. Të gjithë jemi mëkatarë e të gjithë të tunduar e tundimi është buka jonë e përditshme. Nëse ndokush do të më thoshte: 'Jooo, unë nuk jam tunduar kurrë!', ose është kerubin, ose paksi i krisur, apo jo? Kuptohet... Është normale në jetë lufta e djalli nuk rri duarkryq, lufton për të arritur fitoren. Por problemi, problemi më i rëndë që vërejmë në këtë fragment, nuk është tundimi, e as mëkati kundër Urdhërimit IX, por mënyra si vepron Davidi. Davidi nuk flet fare për mëkatin, flet për problemin, që duhet zgjidhur. Kjo është shenja. Kur mbretëria e Zotit mungon, kur Mbretëria e Zotit meket, një ndër shenjat e para është humbja e kuptimit të mëkatit”.

Çdo ditë, kur themi Atynën, ne i kërkojmë Zotit “Ardhtë Mbretëria jote!”, gjë që, kujtoi Papa, do të thotë “t’u rritet pushteti”. Por kur humbet kuptimi i mëkatit, humbet edhe kuptimi i Mbretërisë së Zotit e vendin e saj, nënvizoi Papa, e zë “vizioni antropologjik i mbifuqishëm”, ai që e shtyn njeriun të mendojë se i lejohet të bëjë gjithçka: “Pushteti i njeriut, në vend të Lumnisë së Zotit! Kjo është buka jonë e përditshme, e, prej këndeje, edhe lutja e

përditshme, drejtuar Zotit: 'Ardhtë mbretëria jote, u rritet Pushteti yt', sepse shëlbimi nuk vjen nga dinakëritë tona, nga dhelpëritë tona, nga veletit tona, nga aftësia jonë për t'i ngatërruar punët sipas dëshirës. Shëlbimi do të vijë nga Hiri i Tënzot e nga ushtrimi i përditshëm, që bëjmë për t'u mbushur plot me këtë hir në jetën tonë të krishterë”.

Mëkati i rëndë i sotëm është se njerëzit e kanë humbur kuptimin e mëkatit. Papa Françesku citoi një frazë të famshme të Piut XII e, më pas, u rikthye tek Uria, njeriu që kishte vetëm një faj: gruan e bukur, e që prandaj u çua drejt vdekjes nga vetë mbreti i tij. Uria, vijoi Papa, bëhet kështu, simbol i të gjitha viktimave të mburrjes sonë fajtoze, të parrëfyer: “Po ju rrëfej se, kur i shikoj këto padrejtësi, këtë qëndrim mburracak njerëzor, e kur shikoj se rrezikohem edhe vetë të ec në këtë hulli, kur rrezikohem ta humbas kuptimin e mëkatit, më bën mirë të mendoj jo për një, por për shumë Uri të historisë, që edhe sot vuajnë për shkak të mediokritetit tonë të krishterë, kur ne e humbasim kuptimin e mëkatit, kur e lëmë Mbretërinë e Zotit mbas shpine. Këta janë martirë të mëkateve tona të panjohura, të parrëfyera. Do të na bëjë mirë, sot, të lutemi për të gjithë, që Zoti të na japë përherë hirin të mos e humbasim kuptimin e mëkatit, që Mbretëria e Zotit në ne të mos meket. E edhe të çojmë një lule shpirtërore mbi varrin e këtyre Urive të kohëve tona, që paguajnë shpenzimet e gostisë së njerëzve të sigurt, të krishterëve, të cilët e ndjejnë veten të pafaj, në veprimet e tyre krejtësisht të fajtoze”.



## LUFTA NDAJ KRIMIT DHE DHUNËS FRYT I PUNËS SË PËRBASHKËT

Tiranë, 4 Shkurt 2014

*Ipeshkvijtë e Kishës Katolike në Shqipëri, kanë vënë re me shqetësim një përshkallëzim të dhunës në jetën e përditshme në Shqipëri. Të shqetësuar në mënyrë të veçantë për dhunën në familje dhe atentatet ndaj integritetit fizik të personave, Ipeshkvijtë e Shqipërisë sot kanë dalë me një deklaratë për shtyp në mbrojtje të jetës dhe familjes, që janë dy vlera të cilat duhet të mbështeten e të ruhen nga të gjithë ne. Në këtë deklaratë ata theksojnë se organet e drejtësisë, të policisë dhe të shtetit nuk mund t'ia dalin vetëm pa bashkëpunimin e të gjithëve dhe u bëjnë thirrje të gjithë individëve të mos heshtin, por të bëhen bashkëpunëtorë të organeve kompetente dhe denoncues të krimit kur ai ndodh dhe kur dikush ka qenë dëshmitar.*

*Në fund të deklaratës barinjtë e Kishës Katolike shprehin mbështetjen e tyre të palëkundshme në luftën kundër krimit dhe korrupsionit.*

### Teksti i deklaratës

Ne, Ipeshkvijtë e Kishës Katolike në Shqipëri, ndjekim me kujdes dhe vëmendje zhvillimin e jetës së vendit tonë në përkim me natyrën e saj baritore, jo vetëm duke u kujdesur për të gjithë të krishterët katolikë, por edhe duke kërkuar të jetë faktor paqeje dhe stabiliteti për jetën shoqërore.

Jo pa një farë shqetësimi po ndjekim në kohët e fundit një përshkallëzim të dhunës në jetën e përditshme, në mënyrë të veçantë dhuna në familje dhe atentatet ndaj integritetit fizik të personave. Jeta dhe familja janë dy vlera të cilat duhet të mbështeten e të ruhen nga të gjithë ne. E drejta e jetës dhe e familjes përbëjnë themelin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në mënyrë të veçantë janë institucionet shtetërore ato që duhet të kujdesen për sigurinë e jetës së qytetarëve të tyre. Ne jemi një popullsi e vogël dhe çdo gjë që ndodh ka një ndikim të menjëhershëm në jetën e familjeve dhe individëve, sidomos në një kohë kur mediat dhe mjetet e tjera të informacionit përcjellin gjithçka dhe menjëherë.

Ne si Kishë Katolike mundohemi nëpër komunitetet tona që të përçojmë një frymë bashkëpunimi dhe paqeje, jo vetëm me anëtarët e Kishës Katolike, por me të gjithë bashkatdhetarët. Sigurisht duhet ende shumë punë e duhet të angazhohemi më shumë sidomos në fushën e edukimit nëpërmjet shkollave të administruara prej Kishës dhe grupeve rinore që frekuentojnë famullitë tona.

Por nga ana tjetër ky përshkallëzim i dhunës na shqetëson, aq më tepër kur shpesh vendin e punës për përmirësimin e situatës e zënë polemikat e vazhdueshme, akuzat e ndërsjella dhe përplasjet shpesh të dhunshme të atyre që duhet të jenë shembull dhe t'i prijnë popullit si udhëheqës.

Në radhë të parë ne u drejtohem organeve kompetente që të luftojnë krimin në të gjitha hallkat e tij pa kompromis. Kriminaliteti dhe dhuna megjithatë nuk mund të luftohen vetëm duke bërë ligje më të forta apo duke favorizuar një klimë vetëm ndëshkuese. Kërkohej gjithashtu një strategji e

mirëfilltë edukimi që kalon nëpërmjet shkollës dhe familjes.

Po ashtu shpesh krimi ka si zanafillë varfërinë ekonomike dhe papunësinë e moshës së re. Mjerimet ekonomike që ekzistojnë në familje, papunësia e moshës së re, çojnë drejt lloje krimesh nganjëherë të paimagjinueshme. Si ka thënë Papa Françesku, "Pabarazia shoqërore shkakton herët a vonë një dhunë që armët as nuk e zgjidhin e as munden kurrë ta zgjidhin" (*Evangelii Gaudium*, n. 60). Ne besojmë se politikat e punësimit dhe të edukimit janë parandaluese të krimit jo vetëm në familje, por edhe në shoqëri.

Organet e drejtësisë, të policisë e të shtetit në përgjithësi nuk mund t'ia dalin vetëm pa bashkëpunimin e të gjithëve: *Individët* të mos heshtin, por të bëhen bashkëpunëtorë të organeve kompetente dhe denoncues të krimit kur ai ndodh dhe kur dikush ka qenë dëshmitar i tij; *grupet* e ndryshme shoqërore, ekonomike dhe fetare me institucionet e tyre, me transparencën dhe nxitjen e paqes e të dialogut ndërmjet njëri-tjetrit dhe me të ndryshmit; po ashtu, e sidomos *forcat politike*, duke bërë një politikë konstruktive dhe jo një politikë nxitëse dhe ndjellëse të konfliktit, e cila nxit më shumë dhunën, por nuk zgjidh problemet.

Populli i tëri e sidomos të rinjtë kanë të drejtë të kenë një shembull të mirë dhe siguri në jetën shoqërore. Afati i afërt i marrjes së statusit të vendit kandidat për në Evropë na ngarkon të gjithëve me përgjegjësi, në mënyrë të veçantë politikën, që të jemi bashkëpunues për një rrugë të pakthyeshme dhe të vendosur drejt Bashkimit Evropian, ku ne si popull aspirojmë.

Ne si Barinj të Komunitetit Katolik shprehim mbështetjen tonë të palëkundshme në luftën kundër krimit dhe korrupsionit dhe lutemi që Hyji të frymëzojë mendjet dhe zemrat për një shoqëri shqiptare më të mirë dhe paqësore, larg dhunës dhe arrogancës për zgjidhjen e problemeve dhe të konflikteve.

**Zoti e bekoftë Shqipërinë!**



Don Prend Kola

Zvicër

**PREDIKIMI I FJALËS SE ZOTIT - HOMELIA**

Homelia si pjesë përbërëse e liturgjisë

*Papa Françesku, më 24 nëntor 2013, shpalli pikërisht qarkoren e vet të parë mbi Ungjillin: Evangelii Gaudium (Gëzimi i Ungjillit).*



Fjala predikim (shpallje, kumtim), edhe pse me prejardhje latine, është bërë thujse krejtësisht fjalë e gjuhës shqipe dhe është rrënjësuar mirë edhe në përdorim. Me këtë fjalë nënkuptojmë gjithsecilën shpallje a gjithsecilin kumtim që ka për qëllim përhapjen e Ungjillit, në të vërtetë shpalljen e Lajmit të shpëtimit në Krishtin. Në kuptimin më të ngushtë predikimi është shpallja e Fjalës së Zotit në një Meshë të përcaktuar për të. Dikur Meshët me predikime quheshin Meshët predikuese, dhe bëhej dallimi nga homelia, e cila është përbërëse në kremtimin liturgjik, dhe rrjedh krejtësisht nga leximet, tekstet dhe veprimet liturgjike dhe ka për qëllim të na thellojë në to.

Predikimi e ka zanafillën e vet në shpalljet e para, në kumtimet dhe paraqitjet misionare të Lajmit të shpëtimit të Hyjit para njerëzve, të cilët ende nuk e kishin njohur fenë dhe nuk ishin pagëzuar. Por predikimi u drejtohet dhe ka për qëllim të përforcojë në fe edhe ata që tashmë janë të pagëzuar dhe e njohin fenë, që feja e tyre të ruhet, të forcohet dhe të jetë më e gjallë. Kështu ndodhi gjatë shekujve me shumë misionarë, që quheshin, misionarë popullorë, ndërsa vetë shpallja misionare populllore. Pranë kësaj janë të njohura edhe predikimet kreshmore, të cilat ishin një varg predikimesh në kohën e Kreshmëve me tema përkatëse për kthim, njinessë, pajtim e të tjera.

Homelia është një prej përbërësve më të vjetër të Liturgjisë së Fjalës, e trashëguar nga Sinagoga. Vetë Jezusi i mësonte njerëzit dhe ata magjepseshin nga

mësimi (predikimi) i Tij, sepse fjalën e kishte plot autoritet (*krh. Lk 4,32*). Shën Pali predikoi në shumë qytete të cilat i përshkoi. Edhe në vetë trevat tona shqiptare përqark në Iliri përhapri Ungjillin e Krishtit (*krh. Rom 15,19*). Koncili II i Vatikanit e rivlerësoi veçanërisht, dhe bën të ditur: “Homelia, në të cilën në rrjedhën e Vitit liturgjik, nga tekstet e shenjta do të paraqiten misteret dhe parimet për jetën e krishterë, porositet si pjesë përbërëse e vetë liturgjisë. Në veçanti në Meshat, të cilat kanë për t'u kremtuar të dielave dhe festave të urdhëruara, ajo nuk mund të lihet, përveç për shkak të ndonjë arsyeje serioze” (*Sacrosanctum Concilium*, 52). Meshari thotë: “Edhe pse në leximet nga Shkrimi i Shenjtë Fjala e Hyjit u drejtohet të gjithë njerëzve nga çdo epokë dhe është i kuptueshëm për ta, prapëseprapë një kuptim më i plotë dhe një efektshmëri më e madhe e fjalës selitet a rritet me anë të shpjegimit të gjallë të fjalës, d.m.th., përmes homelisë, si pjesë e veprimit liturgjik” (*Institutio generalis Missalis Romani*, 2002, 29). Homelia si pjesë përbërëse e liturgjisë porositet dhe çmohet, sepse është e nevojshme për mëkëmbjen e jetës së krishterë. Ai që mban homelinë duhet të ketë parasysh shtjellimin e këndvështrimit të leximeve nga Shkrimi i Shenjtë, të ndonjë teksti tjetër të marrë nga Rendi i Meshës, të Veçorit të Meshës së ditës, por pa harruar misterin që po kremtohet dhe nevojat e posaçme të dëgjuesve. Homelia (gr. homilein), do të thotë: ligjëratë, fjalim, mënyrë të drejtuar dikujt (por edhe: flas bashkë me dikë, bëj një bisedë me dikë, bisedë në besim), por si

pjesë përbërëse e Meshës me një qëllim të veçantë. Pra, për të thelluar, shpjeguar, qartësuar leximet e Ungjillit, që ato të mund të kuptohen dhe të zbatohen në jetë. Homelia ka për qëllim që të kuptohet porosia e leximeve; të fusë dritë ungjillore në situatën ekzistenciale të të pranishëmve dhe, përfundimisht, të luajë një rol mistagogjik, do të thotë, të ftillojë besimtarin që tashmë e njeh Fjalën e Hyjit në kuptimin e brendshëm misterplotë të Eukaristisë, sakramenteve dhe të të vërtetave të tjera të fesë. Homelia, kjo mënyrë e shpalljes, që në kuptimin e gjerë nënkupton edhe predikimin në Meshë, haset edhe te Etërit e Kishës (*Justini, Apologjia, 67*) dhe te shumë ipeshkvinj të Kishës së hershme, shkrimet e të cilëve më vonë u përmblodhën dhe u bënë pjesë e Leximit të Orëve (*Hora lectionis*) në Liturgjinë e Orëve.

### **Shërbesa e Fjalës, detyrë parësore e rezervuar e ipeshkvit**

Homelia a predikimi si njëra prej pjesëve më të vjetra të Shërbesës së Fjalës, që detyrë parësore dhe e rezervuar e ipeshkvit, pastaj edhe e të gjithë priftërinjve si zëvendës të tij nëpër bashkësitë famullitare. Homelia, edhe sot, siç na bën të ditur Konkili II i Vatikanit, bën pjesë ndër detyrat parësore të ipeshkvit. Gjykuar sipas kësaj porosie të Konkilit, edhe letra baritore e ipeshkvit ishte dashur të lexohej para popullit, që në këtë mënyrë të plotësojë detyrën e vet, pasi ai nuk mund të arrijë të gjitha famullitë. Në të kaluarën, sipas zakonit të antikës, kur mësuesit ose filozofët ligjëronin ulur, edhe ipeshkvi e mbante homelinë ulur, gjë që na përkujton edhe vetë Krishtin që shpesh mësonte popullin ulur: “Kur pa turmën, u ngjiti në mal. Kur u ul, iu afruan nxënësit e tij. Atëherë mori fjalën dhe i mësoi (*Mt 5,1*).

Si duhet të duket një homeli, një predikim në kuptimin e gjerë të fjalës? Duhet pasur kujdes që homelia t'i referohet ngushtazi misterit të shpëtimit; duhet të shpallen misteret e parimet e fesë dhe të jetës së krishterë nga leximet biblike, si dhe tekstet liturgjike. Pa asnjë dyshim që të gjitha shtjellimet e Shkrimit të Shenjtë duhet të mbështeten në Krishtin si në strumbullarin më të lartë të ekonomisë së shpëtimit; vlen t'i kushtohet kujdes i veçantë edhe kontekstit liturgjik të festës që kremtohet; duhet pasur kujdes që të rrezatojë drita e Krishtit në ngjarjet e jetës dhe të mos zbehet kuptimi i Fjalës së Hyjit, duke marrë gjatë homelisë shembuj dhe tema politike ose njohuri të tjera nga burime të lëvizjeve të rrejtshme që shfaqen në kohën tonë (*Krhs. Redemptionis sacramentum [25 mars 2004], 67*). Përmes fjalës së predikimit marrim edhe porosinë e plotësisë së jetës, ashtu siç na porosit Shën Pali në

Letrën e Kolosianëve: “Përderisa keni pranuar Jezu Krishtin si Zot, jetoni të bashkuar me Të. Tek ai t'i keni rrënjët dhe mbi atë ta ndërtoni jetën tuaj. Bëhuni më të qëndrueshëm në besim, ashtu siç ju kanë mësuar, dhe jini plot mirënjohje. Kujdes se mos ju gënjen ndokush me fjalë filozofike, mashtruese e të kota, fjalë që vijnë nga tradita njerëzore, nga fuqitë shpirtërore të kësaj bote dhe jo nga Krishti” (2,6-8).

Deri më sot kanë mbetur udhërrëfyese qëllimet e predikimit që ka paraqitur Shën Augustini në lidhje me retorikën. Sipas tij janë të rëndësishme tri detyra a qëllime të folësit (*officia oratoris*): docere (mësoj, informoj, sqaroj), delectare (gëzoj, kënaq) dhe movere/flectere/ (lëviz, trand, bind, mallëngjej, prek). Nëse nuk do t'i shikonim këto të tri detyra sipërfaqësisht, atëherë mund të themi: Predikimi duhet të mësojë për Krishtin, që është Mësuesi i mirëfilltë dhe duhet të na drejtojë nga ai; duhet të na gëzojë dhe kënaqë, sepse vetëm Ungjilli përmban përfundimisht gëzimin, është vetë Lajmi i gëzimit; duhet të na lëvizë drejt kthimit; në kuptimin ungjillor duhet të na shkundë. Pra, gjykuar sipas fjalëve latine që përdor Shën Augustini, predikimi duhet të jetë mësim, informim, sqarim, gëzim dhe kënaqje, lëvizje, trandje, prekje dhe mallëngjim. Por Shën Augustini thoshte vetë se, homelia duhet të jetë e këndshme, t'i flasë brendësisë më të thellë të besimtarit dhe ta ndihmojë atë për ta formuar jetën.

Homelia në fijet e para të Kishës që bisedë në besim në mes vëllezërve dhe motrave që ishin të lidhur ngushtë me kremtimin eukaristik. Homelia mbahej në pëlqim a përshtatje të teksteve të lexuara, zbatimit liturgjik nën këndvështrimin e fesë, mënyrës së të jetuarit, jetës së bashkësisë dhe Shërbesës hyjnore. Shpallja e Ungjillit përkundër mënyrës klasike të formave të të folurit u ngrit në gjini. Homelia përmbante mprehtësinë retorike dhe nganjëherë karakterin dialogues: pasthirrma, qeshje, duartrokitje; nuk ka munguar as përgjumja dhe përrallisja, por as ndërhyrja e vetvetishme dhe improvizimet. Homelia mund të shkonte deri në dy orë.

Homelia është shpallje liturgjike e Ungjillit. Prandaj, Papa Gjoni Pali II, thoshte se “Kumtimi i Fjalës së Hyjit, para së gjithash në kremtimin e Meshës, nuk është thjesht vetëm çast mësimi kateistik, por bisedë e Hyjit me popullin e vet, bisedë, në të cilën kumtohet mrekullia e shpëtimit dhe dalin gjithmonë në dukje para syve kërkesat e Besëlidhjes” (*Dies Domini [31 maj 1998], 41*).

Papa Benedikti XVI ka kërkuar që të përmirësohet cilësia e homelisë si pjesë e kremtimit liturgjik. Ai ka shprehur dëshirën që meshtarët ta përgatisin me



kujdes homelinë duke u bazuar në njohjen e përshtatshme të Shkrimit të Shenjtë, të shmangin homelitë e përgjithshme e ato abstrakte dhe, për sa është e mundshme, homelia ta vërë Fjalën e Hyjit në lidhje të ngushtë me kremtimin liturgjik dhe jetën e bashkësisë (*Krh. Sacramentum Caritatis*, 46).

### **Evangelii Gaudium (Gëzimi i Ungjillit)**

Papa Françesku, më 24 nëntor 2013, shpalli pikërisht qarkoren e vet të parë mbi Ungjillin: *Evangelii Gaudium* (Gëzimi i Ungjillit), e cila mban edhe nëntitullin: Mbi shpalljen e Ungjillit në botën e sotme. Një qarkore e tillë me aq tingëllim ëmbëlsues dhe e përthelluar në misterin e Shpalljes, të themi të predikimit a të homelisë, vlen të lexohet dhe të meditohet. Papa porositi se vetë Krishti është “Ungjilli i përgjithshëm” (*Zb 14,6*), dhe vetë Krishti “i njëjti dje, sot dhe përgjithmonë” (*Heb 13,8*). “Mbretëria e Krishtit dhe bukuria e tij”, thotë Papa, “është e pashteruar” (*Evangelii gaudium*, 11). Papa porositi predikatarët që të mësojnë të njohin zemrën e besimtarëve të vet dhe të hetojnë mallëngjimin e tyre gjallërues për Hyjin. Më tej porositen predikuesit: “Homelia nuk duhet të jetë Show-bisedë (s.c. bisedë argëtimi), ajo nuk i përgjigjet logjikës së mundësive mediale, por duhet t’i japë vrull dhe kuptim Shërbesës hyjnore. Ajo është një gjini e veçantë, pasi është një shpallje në tërësinë kuptimore të kremtimit liturgjik; si rrjedhim i kësaj ajo duhet të jetë e shkurtër dhe si e tillë t’i shmanget përngjasimit me një traktat ose me një ligjëratë.

Predikuesi mund të jetë në gjendje të mbajë të zgjuar vëmendjen e njerëzve edhe një orë, por në këtë mënyrë fjala e tij do të bëhet më e rëndësishme se kremtimi i fesë. Po qe se homelia do të zgjatet, dëmton dy tipare të kremtimit liturgjik: harmoninë mes pjesëve të saj dhe ritmin. Nëse shpallja kryhet në kontekstin liturgjik, do të përfshihet si pjesë e flisë, e cila do t’i kushtohet Atit, dhe porsi ndërmjetësim i hirit, të cilin Krishti e zbraz në kremtim. Po e njëjta tërësi kuptimore kërkon që shpallja të drejtojë, edhe bashkësisë, edhe predikuesin në një bashkim me Krishtin në Eukaristi, e cila e shndërron jetën. Kjo kërkon që fjala e predikuesit të mos marrë hapësirë të tepër, kështu që të shkëlqejë më shumë Zotëria sesa shërbëtori” (*Krhs. Evangelii gaudium*, 137).

Kur thuhet homeli, zakonisht mendohet për



kremtimin e Meshës. Në të vërtetë homelia pritet të bëhet edhe në kremtimet e tjera të sakramenteve, bekimeve, devocioneve, Liturgjisë së Fjalës, Liturgjisë së Orëve, e të tjera. Edhe vetë Kodeksi Kanonik porositi homelinë, sidomos në Meshë, për të cilën thuhet që, duhet ta mbajë gjithmonë prifti ose diakoni dhe mos mënjanohej asnjëherë pa arsye të mjaftueshme (*Shih: Codex iuris canonici*, 767, 1-4).

Lidhshmërisht me dëshirat, por edhe me traditën e një populli, predikimi (homelia) shpesh pëson kritika, por edhe lëvdata. Shpesh besimtarët tanë nuk e njohin urtinë e një predikimi të shkruar ose të shprehur me zë të ulët, por më shumë ua mbush mendjen dhe ua bën qejfin predikimi me zë të lartë dhe i pashkruar. Sidoqoftë, populli ynë e ka qejf predikimin dhe, jo rrallë, për besimtarin tonë, predikimi është e tërë Meshja. Kur besimtarit tonë i pëlqen predikimi i meshtarit, thotë: “kam parë Meshë të mirë” ose thotë për priftin: “ka thënë Meshë të mirë”. Mund të shtrohet edhe pyetja: A praktikohet si duhet homelia në Meshat tona, në famullitë tona shqiptare? Duke gjykuar sidomos në bazë të predikimeve nëpër festat e famullive tona, ku dëgjohen shpesh edhe fjalime panegjerieke, druaj se homelia, në kuptimin e Koncilit dhe porosive të papëve po kuptohet mirë dhe gjen zbatimin e duhur.

Shën Pali bën të ditur për secilin meshtar se si duhet të ketë edhe frikë, të frikohet se çka po flet gjatë predikimit, që ai të mos jetë stërhollim i dijes personale të atij që flet, por shfaqje e forcës së kryqit të Krishtit, sepse Krishti, pikësëpari, mendon Shën Pali, “më dërgoi të predikoj Ungjillin, madje ta predikoj, jo me dituri fjale, që të mos i humbë fuqia kryqit të Krishtit” (*1 Kor 1,17*).

Homelia pra, edhe për meshtarin, edhe për diakonin, edhe për besimtarin duhet të jetë mistagogji – fthillim a udhëzim në fshehtësitë jetëdhënëse të fesë sonë.

**Don Nosh Gjollaj, SDB.**  
Podgoricë

## **Faktorët që e shkatërrojnë bashkësinë martesore – familjen!**

(Pjesa e parë)

***Për një martesë afatgjate dhe te lumtur duhet të mposhten: pakënaqësia, murmurimet, dhimbjet apo sëmundjet e papritura, hapja e zemrës, mendjelehtësia (kryeneqësia), imitimi i babës apo i nënës, formimi i identitetit...***

*“Atëherë Almitra foli përsëri dhe tha: Ç’ka thua për Martesën, mësues?”*

Dhe ai u përgjigj duke thënë: Ju lindët bashkë dhe bashkë do të jeni përgjithmonë. Ju do të jeni bashkë kur krahët e bardhë të vdekjes të shpërndajnë ditët tuaja. Do të jeni bashkë edhe në kujtesën e heshtur të Zotit. Por pastë hapësira në bashkimin tuaj. Dhe erërat e qiejve vallëzofshin mes jush.

Duajeni njëri-tjetrit, por mos e bëni vargonj dashurinë. Më mirë ajo të jetë një det lëvizës mes brigjeve të shpirtrave tuaj. Mbusheni kupën e njëri-tjetrit, por mos pini nga e njëjta kupë.

Jepni njëri-tjetrit nga buka juaj, por mos hani nga e njëjta bukë. Këndoni dhe vallëzoni së bashku dhe jini të gëzuar, por secili nga ju të qëndrojnë më vete. Ashtu si telat e ujit janë më vete, edhe pse vibrojnë me të njëjtën muzikë. Dhurojini zemrat tuaja, por pa i futur njërin te tjetra. Sepse vetëm dora e Jetës mund t’i mbajë zemrat tuaja.

Dhe qëndroni bashkë, por jo aq shumë afër; sepse edhe shtyllat e tempullit qëndrojnë më vete, dhe lisi me selvinë nuk rriten në hijen e njëri-tjetrit.” (Kahlil Gibran, Profeti, Tiranë 2003, f. 29-30)

### **Të mposhten murmurima apo pakënaqësia që sjellin dhembjeprurëset**

Fëmija ose foshnja kur e ndiej veten keq ose ka ndonjë dhembje fillon e qanë ose bërtet, po ashtu po qe se është i lodhur atëherë është edhe qaramash i vajtueshëm. Njeriu apo personi i rritur i frenon apo i mposhtë emocionet qofshin ato të dhembjes qofshin ato që e hedhin nga baraspesha e jetës së përditshme. Kuptohet se njeriu i kësaj moshe e kupton zanafillën e dhembjes apo atyre të vuajtjeve edhe ai me arsyen e mendjes së shëndoshë edhe i tejkalon, duke intervenuar për t’i eliminuar në këtë apo në tjetrën mënyrë, si fjala vjen, shkojmë në vizitë te mjeku ose i përdorim hapat kundra dhembjes etj. Por gjithherë mbetet tundim i

përhershëm që nuk e kursen as personin apo individin e rritur, që shumë lehtë dhembja apo ndonjë sëmundje ta shpien në tërheqjen apo regresion, që nuk është asgjë tjetër përveç mekanizmi mbrojtës me të cilin një person kthehet mbrapa, të një sjellje më e hershme dhe më e papjekur që është edhe karakteristika e fëmijëve parashkollor.

Për këtë është mjaft me rëndësi të zgjidhet konflikti, dhembjet, apo vuajtje sa më shpejt që është e mundur, përpara se të tejkalojnë në fazën e neurozës apo ndonjë sëmundje tjetër psikike apo psikosomatike. Po ashtu shumë lehtë shfaqet regresioni edhe në sferën e dashurisë dhe është e theksuar në gjirin martesor posaçërisht te partnerët të papjekur emocionalisht apo afektiv, si fjala bie, në fazën e fejesës, partneri kishte një kujdes të veçantë ndaj dashnores, a tani pas martesës ky kujdes fillon të zbehet. Ose në rastin tjetër si fjala vjen, partneri pëson ndonjë sëmundje të rëndë, siç është paraliza nga fatkeqësia e trafikut dhe individi



është i ngjuar për krevat, thujse për tërë jetën, ashtu mbetet i palëvizshëm etj., në shumicën e këtyre rasteve, pacienti tërhiqet apo kthehet mbrrapa duke u riaktivizuar mekanizmin mbrojtës (regresioni) në atë fazë, që i përngjan fëmijës apo foshnjës në stadin e parë të jetës, që është i varur nga mjedisi e kujdesi i tjetrit.

Vetvetiu kuptohet se një situatë e këtillë e ven në provë jetën e martesës! Në këtë rast nuk është në provë vetëm dashuria por edhe sjellja e partnerit ndaj partnerit të sëmurë. Në këtë kopshtin martesor shumë lehtë krijohet vendi i përshtatshëm e i volitshëm për sëmundjet e llojllojshme recidive, që nuk janë asgjë tjetër përveç rishfaqja e ndonjë sëmundje që kthehet përsëri. Në rastet e këtilla shihet mirë teknika bardhë e zi në të cilën verifikohet pjekuria emotive ose afektive të njeriut apo të individit, pikërisht çiftit martesor. Individi që pëson fatkeqësinë apo, ai që kujdesohet për të, shumë lehtë mund të bie në provim, si fjala bie, ai apo ajo e fajëson spitalin dhe personeli e tij, që nuk kujdesohen për pacientin në mënyrë të mjaftueshëm edhe pse në realitet personeli i kryen detyrën me pedanti (delikates), e ashtu siç duhet për ta shëruar pacientin në fjalë. Për këtë fakt çifti martesor duhet të vetëdijësohet deri në cilën masë tolerohet toleranca apo durimi dhe kur fillon të keqpërdoret dashuria e tjetrit, sepse një është dëshira, e një tjetër është realiteti, dhe nuk bënë të kërkohej jashtë kufijve të mundësisë, as të spitalit në këtë rastin tonë, as nga çifti martesor për t'u ngjuar pranë partnerit të sëmurë. Sepse unë jam i palëvizshëm apo i sëmurë, vallë a do ta dhunojë edhe atë gjysmën tjetër në këtë rast partnerin, duke kërkuar prej tij rolin e mirëbërësit në mënyrë të pakufishme, që me një fjalë i kalon të gjitha kufijtë e dashurisë e njerëzisë. Po qe se e pranon çifti martesor ta lozin rolin e mirëbërësit qoftë të nënës ose të babës, atëherë edhe ai do të hyrë në rrugën e rrezikshme, e cila jo vetëm se do t'ia shkatërron harmoninë e brendshme por edhe do ta humbin baraspeshën e jetës e mos të flasim bashkësia martesore ashtu-ashtu do të falimentojë. Sepse vet partneri i shëndosh, detyrohet të sjellët me partnerin e sëmurë si të ishte ai foshnje apo fëmijë, i cili reagon në çdo lloj sëmundjes, mungesës, dhembjes, mos durimit, e si fëmija e kërkon ta ketë tjetrin pranë vetes, si i tillë jo vetëm se është i mërzitshëm apo i bezdisshëm por bëhet i padurueshëm. Sjellja e tillë jo vetëm se shkaktojnë në personin e shëndoshë në rastin tonë partnerit martesor pakënaqësi por edhe gërdi e ngopje me bezdinë apo mërzinë e tjetrit. Ashtu edhe do të hyrë

në rrathët magjik apo djallëzor nga nuk ka kthim mbrrapa.

Disa herë e kemi theksuar se nuk ka njeri apo individ të përsosur po ashtu as shoqëri, atëherë është e kuptueshme se në çfarëdo bashkësie apo martese do të ketë patjetër ndonjë dhembjeprurëse që sjellë njëfarë doze jo vetëm pakënaqësie por edhe shqetësime, hutime, neveri mos të themi panik apo frikë. Derisa është nën kontrollin e individit gjithçka është në rregull dhe normal, po qe se bëri, e individit e humbë kontrollin ose baraspeshën e normales, atëherë edhe pse dozë e vogël e dhembjeprurëse mund ta kalojë kufirin, pastaj mos të flasim për pasoja që mund të pasojë jo vetëm për individin në fjalë por edhe për bashkësinë e martesës. Tipi i tillë, i përngjanë lëmshit të vogël boret, por kur niset të rrokulliset teposhtë ishte i vogël por gjatë rrugës rritet e zmadhohet aq sa bëhet i rrezikshëm për zhdukjen edhe fshatit në të cilën përplasht. Individi bëhet i paaftë për ta zgjedhë problemin në mënyrë të përshtatshëm ose të natyrshme apo spontane. Femrat zakonisht nga natyra janë mjaft të ndjeshme e lehtë i ngacmon nga çfarëdo dhembje, si fjala bie, ajo është mjaft e ndjeshme dhe ngacmohet lehtë apo shqetësohet gjatë ciklit mujor (menstrual) në veçanti në ditën e parë të menstruacionet. Gjatë kësaj fazës femra është jo vetëm teje e ngacmueshme por edhe pa disponuar, qoftë për dialog ose bisedë, qoftë për çfarëdo punët ose qoftë për çfarëdo zgjedhjet të përbashkët. Në këtë rast, ajo bënë mirë ta sinjalizojnë shokun apo partnerin. Kuptohet se ata përpara akordohen se si dhe çfarë sinjaleve do t'i përdorin në këtë rast apo në ndonjë rast tjetër. Fjala vjen. gruaja e varë flamurin me ngjyrë të verdhë mbi krevatin (shtratin) e fjetjes apo ndonjë vend të dukshëm. Ose ndonjë shenjë apo simbol tjetër, për shembull literatura erotike që sjellë për nocionin e menstruacionit ndër tjera edhe këtë proverb: "Lajmet nga Roma", ashtu ai tjetri pikërisht partneri e kupton. Partneri posa e kupton sinjalin e dërguar nga e dashura, nuk shqetësohet por distancohet e nuk ndërhyrë as me biseda të kota apo therës ose ngacmuese as me vepra por është bile edhe më i kujdesshëm, si në sjellje ashtu edhe për t'u orientuar duke krijuar mjedisin e volitshëm si për veten ashtu edhe për partnerin në fjalë.

Po qe se njëri prej partnerëve bie në depresion ose është i ngarkuar jo vetëm fizik por edhe psikik që e shoqëron mërzia, ankthi, depresioni mos të themi edhe frika. Në situatat e tilla nuk bënë të humbet koka dhe arsyeja e mendjes së shëndoshë, as për t'u brengosë apo të kalohet në histeri ose në



panik, sepse me sjelljet e tillë nuk i zgjedhin problemin por edhe më tepër e ngatërrojnë lëmshin ashtu të koklavitur. Në rastet e tillë është mirë të ruhet jo vetëm gjakftohtësia por edhe një farë distance derisa për rreth neve nuk krijohet apo nuk kthehet harmonia e mëparshme. Po qe se njëri prej partnerëve nuk është i disponuar e një disponim i tillë zgjatë me ditë apo me javë, atëherë është e nevojshëm për t'u thelluar nga buron apo nga e ka zanafillën situata e krijuar, por kurrë nuk është e lejueshme për ta ngacmuar apo për ta thelluar sëmundjen, por me mjeshtri, me durim e mirësi për t'i ardhur në ndihmë partnerit, i cili në këtë rast vuan. Askurrë nuk është e preferuam që t'u ikim problemeve, posaçërisht atyre të brendshme, po ashtu vlen edhe pohimi tjetër, që as mos t'i shtypim në sferën e nënvetëdijes (pavetëdijes) por me guxit të ballafaqohemi me to. Sepse çfarëdo ikje (braktisje) është vdekjeprurëse, që herët a vonë i hakmerret jo vetëm individit por edhe bashkësisë martesore, si fjala bie, ikja apo strehimin në alkool, në drogë, apo në çfarëdo topitje tjetër, jo vetëm se nuk e çliron personin por edhe më tepër e skllavëron apo e tjetërson që herët a vonë bëhet i varur jo vetëm nga alkooli, droga, ilaçet topite por mbet invalid apo gjysmak i pashërueshëm për tërë jetën e tij. Jo vetëm se shkatërrohet individi në fjalë, por ai si i tillë ndikon në mjedisin në të cilin jeton, si për shembull sot në këtë planetin tonë "Blua" vuajnë 30% njerëzve nga alkooli e prej tyre 15% janë alkoolik të rëndë të popullatës. Po qe se personi merr guxim e ballafaqohet me problemin: sy më sy, atëherë mund të shpresojë se do ta realizojë jo vetëm qëllimin por i rikthehet shpresa e humbur, e suksesi nuk do t'i mungojnë as në rrafshin e dashurisë, as në rrafshin i vetëbesimit.

Me tjera fjalë sëmundja apo situata e zymtë që e ka përfshirë njërin prej partnerëve do të zbehet dhe do të zhduket vetvetiu siç edhe ka ardhur në gjirin familjar ashtu edhe do ta lëshoi. Arma më efikase për rastet e tilla është durimi, vetëbesimi dhe shpresa për një ardhme më fatlume e më të freskët që nuk do të mungojnë, sepse njeriu ose individi e ka çelësin e fatit në duart e veta. Fatin dhe lumturin nuk ta sjellë tjetërkush, as nuk të vjen



vetvetiu, as nuk lindë, por ajo arritët me orvatjet të pa ndërpre dita-ditës. Siç thotë një anekdotë Japoneze: "Shkëmbi i madh qëndron i paluhatshtëm dhe i rrënjosur në vendin e vet, e mbi të kalojnë rrebeshi i shiut, i breshëritë, i borës, i vapës, i akullit, e retë e zeza e mbulojnë dhe murrani i pamëshirshëm përplasë në të, por ai qëndron i palëkundshëm!" Të gjitha kalojnë e shkëmbi mbetet shkëmb. Ashtu vlen edhe për njeriun, kurse shkëmbi në fjalë nuk është asgjë tjetër përveç identiteti i njeriut, që me kohë ai e ka krijuar qoftë atë kombëtar, etiko-moral, fetar, gjinor, të mendësisë ose pikëpamjeve të jetës apo filozofia e jetës.

Pikëpamjet e tilla janë të rëndësishme, në veçanti për çiftin martesor, të cilët duhen të vetëdijesohen dhe të mësohen për ta bartë njërit-tjetrit brengat, mërzinë çfarëdo dhembjeprurëse që e sjellë. Kuptohet gjithherë e kurdoherë me sinqeritet, me dashuri dhe nga gjiri i tyre duhet jo të flaket murmuritja, (nynkamja), pakënaqësi por edhe ngarkesat e fajësimit. Sepse në rastet e shumta, din ai tjetri ( i sëmuri) t'ia hedhin barrën tjetrit, duke e ngarkuar partnerin me barrë e rënd, jo vetëm se e dëmton veten por edhe tjetrin e së bashku hyrë në rrethin magjik praj kah s'ka as shtegdalje. Në të kundërtën po qe se frenohemi e njëherë ballafaqohemi me realitetin e dhembjeprurëseve, atëherë as shpërblimi nuk do t'i mungojnë, sepse i rikthehet dhurata e fati, lumturisë, e dashurisë dhe e harmonisë. Partneri i shëndoshë, i cili e ka baraspeshën normale, jo vetëm se do t'ia lehtësoi barrën partnerit të sëmurë, por atij t'ia sjellë edhe ngrohtësinë, dashurinë dhe paqen duke shpresuar se një ditë do të shndrisin edhe dielli i dashurisë.

## ZOJA FATIMA - MREKULLIBËRËSJA

*Në të gjitha shfaqjet e Saja në Fatima, Nëna e Lume nënvizoi vazhdimisht nevojën për të lutur çdo ditë Rruzaren, për të veshur Petkun e Zojës Karmë dhe për të kryer vepra kthimi dhe sakrifice.*

Tre barinj të vegjël, vëlla e motër Françisko Marto dhe Giacinta (Xhaçinta) Marto (9 e 7 vjeç) dhe kushërira e tyre Luçia dos Santos (10 vjeç), më 13 maj 1917, ndërsa kujdeseshin për kullosën në vendin Cova da Iria, afër qytetit të Fatimas, treguan se kanë parë të zbresë një re dhe, nga hollësia e saj, të shfaqej figura e një gruaje të veshur me të bardha me një rruzare në dorë: Zojën. E gjitha kjo ngjau në një moment në të cilin qytetërimi ishte shkatërruar nga lufta dhe dhuna e përgjakshme, Ajo premtoi që Qielli do t'ia kishte dhënë paqen gjithë botës nëse kërkesat e Saja të lutjes, kthimit dhe përkushtimit do të kishin qenë dëgjuar dhe zbatuar.

Zoja e Fatimas u shpjegoi fëmijëve se lufta është një ndëshkim për mëkatin dhe paralajmëroi se Hyji do të kishte ndëshkuar më tej botën për mosbindje ndaj Vullnetit të Tij dhe për persekutimin e Kishës, të Atit të Shenjtë dhe të Fesë Katolike. Nëna e Hyjit profetizoi se: “Nëse kërkesat e mia nuk do të plotësohen, Rusia do të përhapë gabimet e veta në botë, duke provokuar luftëra dhe persekutime kundër Kishës. I miri do të martirizohet, Ati i Shenjtë do të vuajë shumë dhe kombe të ndryshme do të asgjësohen”.

Në të gjitha shfaqjet e Saja në Fatima, Nëna e Lume nënvizoi vazhdimisht nevojën për të lutur çdo ditë Rruzaren, për të veshur Petkun e Zojës Karmë dhe për të kryer vepra kthimi dhe sakrifice. Për të parandaluar ndëshkimin e tmerrshëm të pashmangshëm të Rusisë dhe për të kthyer atë komb, Zoja kërkoi Kushtimin solemn publik të Rusisë Zemrës së Papërlyer të Saj nga ana e Papës dhe e të gjithë ipeshkvijve katolikë të botës. Ajo kërkoi edhe që besimtarët të praktikonin një devocion të ri kthimi të Shtunën e parë për pesë muajve të njëpasnjëshëm (“pesë të Shtunat e Para”).

Thelbi i Mesazhit të Zojës drejtuar botës përmbahet në atë që më vonë u quajt “Sekreti” që Ajo ua besoi tre veguesve të vegjël në korrik të vitit 1917. Në të vërtetë përbëhet nga tre pjesë. Pjesa e parë e Sekretit ishte një vizion i tmerrshëm i ferrit “ku shkojnë shpirtrat e mëkatarëve të mjerë” dhe përmbante një thirrje urgjente nga ana e Zojës për vepra lutjeje dhe sakrifice për të shpëtuar shpirtrat. Pjesa e dytë e Sekretit profetizonte në mënyrë të veçantë qëllimin e Luftës së Dytë Botërore dhe përmbante kërkesën solemnë të Nënës së Hyjit për





Kushtimin e Rusisë si kusht për paqen në botë. Ajo parashikonte edhe triumfin e pashmangshëm të Zemrës së Saj të Papërlyer pas Kushtimit të Rusisë dhe kthimit atij kombi në fe.

Giacinta (Xhaçinta) dhe Françisko vdiqën në moshë të re gjatë epidemisë së gripit spanjoll, ndërsa Luçia dos Santos u bë motër Karmelitane dhe ruajtëse e sekretit të Fatimas. Pjesa e fundit e Sekretit (shpesh i quajtur “Sekreti i Tretë”) u shkrua nga motër Luçia, dhe është në zotërim të Selisë së Shenjtë nga viti 1957.

Kur Zoja ia besoi Sekretin e Fatimas tre veguesve, e Lumja Virgjër premti edhe që Hyji do të kishte bërë një mrekulli të madhe tetorin e ardhshëm “kështu që të gjithë do të mund të besojnë”. Më 13 tetor 1917, në prani të 70.000 dëshmitarëve okularë, në qiellin mbi Fatiman ndodhi një mrekulli pikërisht në momentin dhe në vendin e saktë të lajmëruar më përpara nga fëmijët. Dëshmitarët treguan se dielli në të vërtetë dukej sikur “kërcente” në qiell dhe binte në tokë para se të kthehej të zinte pozicionin e tij normal.

Kjo ngjarje tani njihet si “Mrekullia e Diellit” dhe me të drejtë është përcaktuar si ngjarja më e madhe mbinatyrore e shekullit të njëzetë.

Në vendin e shfaqjeve u ndërtua një Shenjtërore në nder të Zojës së Fatimas.

Më 13 maj 2000 vëlla e motër Giacinta (Xhaçinta) dhe Françisko u shpallën të lum. Në të njëjtin vit u zbulua pjesa e fundit e sekretit të Fatimas në lidhje me sulmin e pësuar nga papa Gjon Pali II, që u plagos më 13 maj 1981 në pjacën e Shën Pjetrit.

Mbi aprovimin e Fatimas ... Në vitin 1930 Kisha Katolike ka nënshkruar zyrtarisht Mesazhin e Fatimas “si i besueshëm”. Pesë Papët në vazhdim kanë shfaqur publikisht aprovimin e tyre dhe besimin e tyre në vlefshmërinë dhe në rëndësinë thelbësore të shfaqjeve të Fatimas. Papë të ndryshëm kanë vizituar Shenjtëroren e Fatimas në pelegrinazhe solemne dhe Papa Gjon Pali II ka shkruar të paktën një herë për çdo dekadë të pontifikatit të tij. Shenjtëria e tij i ka atribuuar publikisht Zojës së Fatimas shpëtimin e tij në lidhje me tentativën për vrasje të 1981.

“Në fund Zemra ime e papërlyer do të triumfojë. Ati i Shenjtë do të ma kushtojë mua Rusinë e ajo do të kthehet dhe do t'i jepet botës një periudhë paqeje”.

Pavarësisht nga paralajmërimi i ashpër në lidhje





me ndëshkimet e tmerrshme për mëkatën dhe mosbindjen, Fatima mbetet në thelb një pohim jete dhe Feje dhe një mesazh shprese e paqeje për të gjithë Katolikët dhe për të gjithë njerëzit vullnetmirë kudo në botë.

“Vetëm Unë mund t’ju ndihmoj. Zemra ime e papërlyer do të jetë strehimi juaj dhe rruga që do ju udhëheq tek Hyji”.

### ***Kërkesat e Zojës Fatima për të sjellur paqen në botë***

1. Për falje dhe ndërmjetësim: “Kam ardhur që të qortoj besimtarët që ata të ndryshojnë jetë e të kërkojnë falje për mëkatet e tyre. Ata nuk duhet që të fyejnë më Zotin tonë, sepse tepër e kanë fyer”

2. Rruzarja: “Luteni rruzaren çdo ditë që të keni paqe për botën. Pas çdo dhjetëshe shtoni: O Jezusi im, na i fal mëkatet tona, na shpëto prej flakës së ferit, çoi në qiell të gjithë shpirtrat, sidomos ata që kanë më shumë nevojë për Mëshirën Tënde”.

3. Të shtunat e para: “Unë premtoj ndërmjetësim në çastin e vdekjes për të gjithë ata që në të parën të shtune të muajit për pesë muaj:

1. do të rrëfihen e do të kungohen
2. do të lusin rruzaren
3. do të meditojnë për një çerek ore misteret e rruzares, me qëllim ndërmjetësimi për mëkatet



4. Paqja nëpër Marinë: “Thuajuni të gjithëve se Zoti, do të japë hire nëpër Zemrën time të Papërlyer dhe që Zemra e Krishtit dëshiron të jetë e nderuar së bashku me Zemrën time të Papërlyer. Zoti ma ka besuar mua paqen e botës.”

### **AKT BESIMI NË DUARTE MARISË**

E lumja Mari Virgjër e Fatimas, me mirënjohje të përtërirë për praninë tënde amënore

bashkojmë zërin tonë me atë të të gjitha breznive që të quajnë të lume.

Kremtojmë në ty veprat e mëdha të Hyjit, që kurrë nuk lodhet së përkuluri me mëshirë mbi njerëzimin, e munduar prej së keqes dhe të plagosur prej mëkatit,

për ta shëruar dhe për ta shëlbuar.

Pranoje me dashamirësinë prej Nënë aktin e besimit që sot po të bëjmë, para kësaj trupores tënde aq të dashur për ne.

Jemi të sigurt se secili prej nesh është i çmueshëm në sytë e tu dhe se asgjë nga ato që kemi në zemër nuk është e huaj për ty.

Lejojmë të na arrijë vështrimi yt tejet i ëmbël dhe marrim përkëdheljen ngushëlluese të buzëqeshjes sate.

Ruaje jetën tonë në krahët e tu:

bekojë dhe forcoje çdo dëshirë për të mirën;

gjallëroje dhe ushqejë fenë;

mbështete dhe ndriçoje shpresën;

ngjalle e frymëzoje dashurinë;

na drejto të gjithëve ne në ecjen e shenjtërisë.

Na mëso dashurinë tënde përzgjedhëse për të vegjlit dhe të varfërit, për të përjashtuarit dhe të vuajturit, për mëkatarët dhe të përhumurit në zemër:

mbledhi të gjithë nën mbrojtjen tënde dhe të gjithë dorëzoja Birit tënd të dashur, Zotit tonë Jezusit.

Amen.

**Prof. dr. Uran Asllani**

Tiranë

## SI E MBROJTËN ÇËSHTJEN SHQIPTARE KLERIKËT KATOLIKË NË KONFERENCËN E PAQES

**Personazhet e panjohura të dërgatës shqiptare në Konferencë. Negociatat e Bumçit e Fishtës: Jo copëtimet të Shqipërisë Memorandumet e delegacionit shqiptar: Njohja e pavarësisë dhe bashkimi me Kosovën e Çamërinë. Halil Pashë Alizoti dhe mërgata e Stambollit në Konferencën e Paqes.**

Në fillim të vitit 1919 dhe gjatë tij, deri në fillim të vitit 1920, në Paris, zhvilloi dhe përfundoi punimet Konferenca e Paqes, e organizuar nga pesë Fuqitë e Mëdha fituese të Luftës së Parë Botërore, Anglia, Franca, ShBA, Italia dhe Japonia. Në këtë luftë, Shqipëria nuk kishte qenë palë në asnjërin krah, as me fituesit dhe as me të mundurit. Megjithatë, ajo ndodhej e pushtuar nga forcat ushtarake të disa fuqive fituese, të cilat synonin të dhunonin pavarësinë dhe të cenonin tërësinë e saj tokësore. Shqipëria duhej dhe do të dërgonte në Paris delegacionin e saj dhe me përfaqësuesit e saj do t'i kërkonin Konferencës rishikimin e padrejtësive të së kaluarës, me shpresë se mund të respektohej parimi i vetëvendosjes.

Kongresi i Lushnjës, që u zhvillua në ditët e fundit të janarit 1920, përveç qeverisë së re shqiptare, caktoi, gjithashtu, përbërjen e delegacionit që do të shkonte në Konferencë. Përveç kryeministrit, i cili do të kryesonte delegacionin, si anëtarë të tij do të ishin ministri i Punëve të Jashtme Mehmed Konica, imzot Luigj Bumçi, ministër pa portofol, ipeshkvi i Dioqezës së Lezhës, dr. Mihal Turtulli dhe Mit'hat Frashëri. Delegacioni shqiptar i Qeverisë së Durrësit mbërriti në Paris më 4 shkurt 1919. Menjëherë ai i paraqiti Konferencës së Paqes dy memorandume me kërkesat e veta, që kishin në themel programin politik të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të miratuar në Kongresin e Durrësit. Në këto dy dokumente, pavarësia e Shqipërisë quhej tashmë e fituar dhe e njohur ndërkombëtarisht me vendimet e vitit 1913 në Konferencën e Ambasadorëve. Mirëpo, kërkesa për t'i bashkuar shtetit shqiptar Kosovën dhe Çamërinë lidhej me

dy vende që kishin dalë fituese nga Lufta e Parë Botërore dhe, si të tilla, kufijtë e tyre shtetërore të paraluftës nuk u vunë në diskutim. Kur u konstatua se kërkesat shqiptare për zgjerimin e kufijve shtetërorë nuk gjetën asnjë përkrahje dhe se kishin nisur të shqyrtoheshin, madje të gjenin edhe miratim pretendimet territoriale të vendeve fqinje, ky delegacion i parashtrroi më 7 mars Konferencës një propozim, ku kërkohej që çështja e Kosovës dhe e Çamërisë të zgjidhej sipas parimit të drejtë të vetëvendosjes së popujve.

Mirëpo, Konferenca e Paqes nuk i mori parasysh as kërkesat e delegacionit shqiptar për rishikimin e kufijve, as edhe propozimin e tij për organizimin e një plebishiti në trevat që kërkonin t'i merrnin fqinjët ballkanikë. Pikërisht në këtë periudhë, kur delegacionit qeveritar po i dilnin gjithë këto vështirësi, nga shqiptarët e diasporës

dërgohen në Paris delegacionet e tyre në mbështetje të kërkesave shqiptare. Ndërkohë që edhe përbërja e delegacionit të Durrësit në qershor ndryshoi thellësisht. Kështu, në krye të delegacionit u zgjodh imzot Luigj Bumçi, me anëtarë Mehdi Frashërin, Luigj Gurakuqin, Mustafa Kruja, Lef Nosi dhe përsëri Mehmed Konicen e dr. Mihal Turtullin, me sekretar të delegacionit at Gjergj Fishtë. Qëndrimi i imzot Bumçit deri në këtë kohë kishte qenë më i moderuar, por, megjithëse ishte katolik ishte kundër proteksionit italian, ky ndryshim nuk u mirëprit nga Italia. Nga delegacionet e kolonive, më i rëndësishmi, që ndikoi fuqishëm në veprimtarinë e delegacionit të imzot L. Bumçit, ishte ai që përfaqësonte mbi 50000 shqiptarët e Stambollit. Ai përbëhej nga Halil Pashë Alizoti (Gjirokastra), Fuad bej Dibra, at



(imzot) Jul Bonatti dhe Shan Tepelena. Të tjera delegacione të rëndësishme ishin edhe ai i Bukureshtit me Pandeli Evangjelin në krye edhe ai i shqiptarëve të SHBA, me Parashqevi Qiriazin e pastorin amerikan, Telford Eriksonin në krye.

Në mbledhjen e përbashkët të delegacioneve u vendos që të gjitha delegacionet do të mbështesnin qëndrimin e delegacionit qeveritar të kryesuar nga imzot Luigj Bumçi, mbi tërësinë territoriale, të pavarësisë dhe të sovranitetit të shtetit shqiptar. Roli i Imzot Bumçit në zgjidhjen e çështjes shqiptare, në atë Konferencë, si kryetar i delegacionit zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, rritet së tepërmi. Që në fillim të detyrës së re, Luigj Bumçi, me cilësinë e kryetarit të delegacionit shqiptar në

Paris, protestoi te presidenti Willson për krimet e kryera nga serbët mbi popullsinë e Pejës, Gjakovës, Plavës e Gucisë. Ai i dërgoi atij listën e viktimave në zonën e Rugovës dhe kërkonte që trupat amerikanë të futeshin në këtë zonë. Për ato krime ai vetë kishte qenë dëshmitar qysh nga viti 1911

**Po cili ishte imzot Luigj Bumçi, të cilit, aktualisht, shumë pak ia njohin biografinë?**

Ai lindi në Shkodër më 7 nëntor 1872, në familjen e tregtarit të vogël të peshkut, Gjon Bumçit dhe motrës së Vaso Pashë Shkodranit. Studimet fillestare i ka kryer pranë institucioneve jezuite: Seminarit tregtar e më pas në Kolegjin e Shën Saverit, në Shkodër. Studimet e larta në Teologji dhe Filozofi i vazhdoi dhe i përfundoi në Romë, më pranë Propagandës Fide në mars të vitit 1903. Ndenji pak kohë në Romë dhe, po aty, më 3 maj 1903, u dorëzua meshtar (famullitar). Në fund të vitit 1903 u kthye në Shkodër. Për gjatë shtatë viteve, duke filluar punën si famullitar fillimisht në Shkrel, më pas në Pentar dhe në vitin 1910 në Juban, ku u shugurua ipeshkëv. Në fillim të vitit 1911, si pasojë e politikës shkombëtarizuese



Luigj Bumçi

antishqiptare të xhonturqve, shtimit të barrës së taksave, mobilizimit të detyrueshëm ushtarak e çarmatimit të popullsisë në Malësinë e Madhe, më 23 mars plasi kryengritja e Malësisë së Madhe. Kryengritja kundra ushtrisë së gjeneralit famëkeq, Xhavid Turdut Pashës, u shtri në të gjithë Hotin, Grudën, Kelmendin, Kastratin, Shkrelin e Shalën. Drejtimin e saj e mori Komiteti i formuar në Podgoricë, i cili hyri në lidhje edhe me komitetet e tjera, brenda dhe jashtë vendit. Metropolitani i Shkodrës, imzot Jak Serreqi, duke njohur aftësitë paqëtuuese dhe ndikimin që kishte imzot Luigj Bumçi

midis malësorëve të Malësisë së Madhe, veçanërisht me bajraktarët e Shkrelit dhe Kelmendit, me kërkesën e këtij të fundit e dërgoi atë në ndihmë të komitetit të Podgoricës në rolin e ndërmjetësit, por edhe të përkthyesit.

Mbas përfundimit të kryengritjes, imzot Luigj Bumçi kthehet në Shkodër, pranë Argjipeshkvisë, e cila në fillim të vitit 1912 e përzgjedhi ipeshkëv të dioqezës së Lezhës, me qendër Kallmetin. Nuk kishte kaluar më shumë se një muaj që Luigj Bumçi ishte bërë kryetar i delegacionit të qeverisë së Durrësit në Paris, kur nënshkruhet më 29 korrik 1919 marrëveshja Titoni-Venizellos (Itali-Greqi), sipas së cilës Roma do të mbështeste në Konferencën e Paqes kërkesën greke për aneksimin e Korçës dhe të Gjirokastrës, ndërsa Greqia njihte aneksimin italian të Vlorës, si dhe mandatin italian mbi shtetin e cunuar shqiptar. Një vendim i tillë u prit me shqetësim të madh në radhët e delegacionit shqiptar në Paris.

L. Bumçi, për të diskutuar këtë problem, u takua personalisht me ministrin e Jashtëm italian në Paris, më 26 tetor 1919. Diplomati italian përgjigjet se marrëveshja "Tittoni-Venizelos" nuk kishte ndonjë



rëndësi të madhe dhe se zbatimi i saj varej dhe nga shumë rrethana të tjera. Kjo përgjigje nuk e qetësoi kryedelegatin shqiptar.

Gjithashtu, imzot Bumçi u takua në tetor të 1919-s edhe me ministrin e Jashtëm të Francës, S. Pichon, me kryetarin e përkohshëm të delegacionit amerikan, White (Uait), si dhe me përfaqësues të delegacionit anglez, të cilëve iu kërkuar të përdornin autoritetin e tyre në të mirë të çështjes shqiptare.

Rreziku i madh i copëtimit të vendit e detyroi delegacionin e qeverisë së Durrësit që të dërgonte kryetarin e vet, L. Bumçi, në Vatikan, për të takuar personalisht Papa Benediktin XV, të cilit, në emër të shqiptarëve, t'i kërkonte të përdorte autoritetin e vet në mbrojtje të krahinave të Korçës dhe të Gjirokastrës nga aneksimi grek, me qëllim që krahinat në fjalë t'i mbeteshin Shqipërisë. Në këto kushte, më 26 dhjetor 1919, Luigj Bumçi nis për në Vatikan, ku arriti më 29 dhjetor 1919.

Në ditët e para të janarit, kryedelegati shqiptar u takua me Papën, Papa Benedikti XV, pasi e sqaroi ipeshkvin shqiptar se nuk mund të ndërhynte pranë qeverisë së Italisë dhe Francës, sepse marrëdhëniet e Vatikanit me këto qeveri nuk ishin të mira, i premtoi atij se do të takohej urgjentisht me ambasadorët, anglez dhe amerikan në Vatikan, të cilëve do t'u kërkonte të qëndronin në krah të popullit shqiptar. Grupi katolik në Parlamentin italian i kërkonte kryeministrit Francesco Nitti që Italia të përpiquej me të gjitha mënyrat për të mos shkaktuar copëtimin e Shqipërisë.

Gjithashtu, më 5 shkurt 1920, imzot Bumçi shkoi në Belgjikë për të takuar kardinalin e atjeshëm, Mercier, për të biseduar me të për problemet e shqiptarëve.

Duke parë se në të gjitha memorandumet që Fuqitë e Mëdha kishin përgatitur dhe diskutuar në Konferencën e Paqes, ato mbështesnin mandatin italian mbi shtetin shqiptar, delegacioni i qeverisë së Durrësit, nën udhëheqjen e imzot Bumçit, në mbledhjen e vet të datës 9 dhjetor 1919, ku në cilësinë e sekretarit të delegacionit asistonte edhe at Gjergj Fishta, vendosi t'u dërgonte një memorandum Fuqive të Mëdha, për t'u kërkuar atyre vendosjen në krye të shtetit shqiptar të një princi italian nga familja mbretërore e Savojës, për të mënjeluar kështu mandatin real italian mbi Shqipërinë.

Ndërsa në mars të vitit 1920, imzot Bumçi dhe Mihal Turtulli, me cilësinë tani edhe të anëtarëve të Këshillit të Lartë të zgjedhur në Kongresin e Lushnjës, shkuan në Londër për të tërhequr përkrahjen e Mbretërisë së Bashkuar për çështjen

shqiptare.

Në kryeqytetin britanik, përveç kolonel Aubrey Herbert-it dhe miss Durham-it, delegacioni shqiptar u takua edhe me Filip Kerr (sekretar i Ministrisë të Jashtëm anglez) dhe Leeper (ekspert për çështjet ballkanike pranë delegacionit anglez në Paris) etj.

Nga takimet e shumta të kryera prej tij në Londër, kishte mësuar në radhë të parë opinionet e politikanëve britanikë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Midis të tjerash, ai i shkruante Tiranës “puna që na ka sjellë dëm më të madh është mendimi se shqiptarët nuk janë në një mendim dhe se nuk mirren vesht në mes të tyre. Si këtu, në Paris, po më tepër në Londër, morëm vesh se shumë prej shqiptarëve kanë kërkuar nga Konferenca proteksionin me Greqinë, Italinë a me Jugosllavinë.” Në këto rrethana, shkruan imzot Bumçi, jam ballafaquar me një mendim të kristalizuar mirë, fatkeqësisht, në radhët e vendimmarrësve evropianë se shqiptarët nuk kishin aftësi të vetëqeveriseshin. Por, duke qenë se ishte e domosdoshme të sigurohej mbështetja e kancelarive evropiane për të realizuar synimet në drejtim të zgjidhjes së çështjes kombëtare, imzot Bumçi i porosiste: “Pikë së pari duhet pra të kemi bashkim të plotë, urtësi të madhe, durim e nderim për njëni-tjetrin. Duhet të shuajmë hidhënimet e meritë që na ndajnë, të respektojmë mendimet e shokëve tanë e të mos ftohim e të mos ashpërsojmë marrëdhëniet ndërmjet Shqipëtarëve të çdo krahine apo të çdo besimi që të jemi.....”

Puna dhe përpjekjet e imzot Bumçit në krye të delegacionit zyrtar shqiptar, për të mbrojtur çështjen kombëtare në Konferencën e Paqes së Parisit, veprimtaria e tij diplomatike plot maturi e vendosmëri, përbëjnë një kontribut të çmuar në njërin prej çasteve më delikate të historisë së popullit shqiptar.

Një ndihmë dhe mbështetje të fortë e të fuqishme veprimtarisë së imzot Luigj Bumçit i dha delegacioni i Stambollit, me në krye Halil Pashë Alizotin, me këshilltarin e tij ideologjik-politik, atdhetarin e njohur at (imzot) Julius Bonatin. Po cili ishte ky klerik katolik i panjohur dhe i papërmendur në studimet historike shqiptare? Në Stamboll ishte stabilizuar prej shumë vitesh familja katolike shkoderane, Bonatti. Ajo familje i kishte dhënë Lëvizjes Atdhetare Shqiptare tri personalitete të rëndësishme. Ata ishin Aleksandër bej Bonatti; Nikollë Bonatti dhe Gjon Bonatti. Këta dy të fundit ishin edhe anëtarë efektivë të Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip. Në katër katolikët

shqiptarë, 28 anëtarët e shoqërisë ishin edhe Pasko Vasa e Nosh (Ndoc) Xhuxha.

Sipas dokumenteve të hetuesisë së Vlorës, rezulton se imzot Jul (Julius) Bonati kishte lindur në Shkodër, më 4 maj 1874, në familjen e atdhetarit Aleksander Bonati dhe të Rozës; Për Jul Bonattin nuk dihet ku ka kryer arsimimin fillor, në Shkodër apo në Stamboll. Seminarin dhe studimet universitare për Teologji dhe Filozofi i kreu pranë Universitetit të Vjenës. Më pas dërgohet pranë Universitetit të Padovës për të studiuar dhe përfunduar studimet në Letërsi, duke marrë edhe doktoratën. Mbas mbarimit të studimeve shkoi në Stamboll, si famullitar i Kishës katolike të Shën Ospit, në lagjen "Taksim" të kryeqytetit osman. Në vitin 1909, at Jul Bonati ishte në Stamboll dhe i afirmuar si një atdhetar me vlera. Pikërisht në këtë kohë shkoi në Stamboll Hil Mosi, pasi kishte mbaruar studimet pedagogjike në Klagenfurt të Austrisë; Me rekomandimin dhe interesimin e at Jul Bonatit, Hil Mosi filloi punën pranë redaksisë së gazetës "Shqiptari" të Dervish Himës, si gazetar dhe sekretar. Në Stamboll, at Jul Bonatti ka marrë pjesë aktive në Lëvizjen Atdhetare të Kolonisë Shqiptarë të Stambollit, duke vazhduar dhe ndjekur traditën atdhetare të të atit të tij, Aleksandrit. Njëkohësisht duke qenë një njohës i mirë i gjuhës osmane dhe latinishtes, përveç gjuhëve të tjera europiane, at Jul Bonatti gjatë 16 viteve shërbim në Stamboll ka kryer studime të thelluara në çështjet e historisë së trevave shqiptare.

Mbas Konferencës së Paqes, at Julius Bonatti u kthye në Stamboll. Më pas, në vitin 1928 kthehet në Shqipëri dhe menjëherë u caktua në dioqezën e Durrësit si ndihmës i imzot Vinçens Prendushi. Në vitin 1938, ai shugurohet ipeshëk i dioqezës së re, në atë të Vlorës. Me kushte të vështira pune dhe jetese, imzot dr. Jul Bonatti jetoi dhe punoi në Vlorë deri në vitin 1942. Në atë vit ai transferohet pranë Selisë së Shenjtë dhe për arsye të sëmundjes dërgohet në spitalet e Montekatinit. Atje ai u mor me hulumtime dhe kërkime në fushën e letërsisë shqiptare dhe të huaj, duke lënë vepra të vyera. Ka përkthyer në gjuhën italiane pjesë nga «Lahuta e Malcis» e at Gjergj Fishtës. Gjithë krijimtaria e tij ka humbur, është eliminuar, ose ka mbetur në Itali. Në prag të mbarimit të Luftës II Botërore, në vitin 1944, imzot Jul Bonatti pati një mbledhje shumë të rëndësishme, së bashku me klerikë të tjerë të



Père Georges Fishta, O. F. M. - Le plus grand Poète d'Albanie

vendeve të Europës Lindore me papa Piun XII. Për t'u përgatitur për kushtet e regjimit komunist, imzot Jul Bonatti, në verën e vitit 1946 kthehet në Tiranë dhe dërgohet sërish në Vlorë, por aty nuk mundi të shërbente me shumë se dy muaj. Në Vlorë, më 6 nëntor 1946, arrestohet dhe burgoset. Mbas pothuaj një vit hetuesie, imzot Jul Bonatti, më 1 tetor 1947 dënohet me 7 vite burg. Ky dënim u kthye në 5 vite nga Gjykata e Lartë. Ndërkohë, imzot Jul Bonatti, nga gjendja e dëshpërimit të thellë sëmurët nga sistemi nervor. Drejtorja e burgut në Vlorë e dërgoi në Spitalin Psikiatrik të Durrësit, ku vdiq i sakatuar në moshën 75-vjeçare. Shembulli i këtyre prelatëve katolikë tregoi qartazi se kleri katolik, duke filluar nga shekulli XVII, vijoi t'i shërbente me devocion kombit të vet.

Edhe pse aspirata e tyre për një Shqipëri tërësore dhe të bashkuar brenda kufijve të saj etnikë nuk u përmbush, Konferenca e Paqes e Parisit, të paktën, nuk lejoi zhdukjen nga harta politike e Ballkanit të shtetit shqiptar.

**Frano Kulli**  
Lezhë

## PELEGRINAZH NË KUKLIN E MJEDËS

Pelegrinazhi i fundit kulturor në Kukël, një fshat diku ndërmjet Shkodrës e Lezhës, mbështetur në njërën faqe të malit të butë të Kakarriqit, ku zë fill fusha e begatë e Zadrimës, është bërë verës që shkoi... Shumëkujt nuk i thotë asgjë emri i këtij fshati vocrrak, por jo gjithkujt, kështu. Edhe atij që nuk i ka rënë rasti të kalojë andej pari, Kukli i krijon menjëherë bashkëshoqërimin me emrin e Mjedës.

Ndre Mjeda, poeti, albanologu, gjuhëtari, politikani (ishte deputet i Shkodrës në të parin parlament shqiptar në vitin 1923, bashkë me Fishtë, Gurakuqin e të tjerë) kaloi aty dhe katund m'katund nëpër Zadrimë, rreth tri dekada të jetës së vet, në fillim shekullin e njëzetë. Ishte famullitar i Kuklit, aty u mësoi besimtarëve të tij, bashkë me ritin e lutjeve, edhe ritin e nxënës. Ata përfutuan prej tij plot dije të tjera për botën e vogël rreth tyre dhe për atë botën e largme atje tej, por mësoi me to edhe vlagën e tokës e buisjen e sythit. Ai u solli atyre të parat makina bujqësore, të cilat aso kohe, me zor i kapërdinte edhe ëndrra e tyre më e bukur. Aty shkroi "Andrra e jetës", aty shkroi, disa prej tingëllimave të tij të mrekullueshme, të "Juveniljes", gjithashtu. Aty... derisa u nis për në rrugën e amshimit, në vitin e largët 1937... Studiuesi pasionant Mentor Quku, një pjesë të madhe të lëndës së tij dhjetë vëllimëshe jetëshkrimore për poetin e ndritur, ia ka kushtuar Kuklit.

Gjërat e Mjedës, që akoma jetojnë në Kukël, janë kisha e vogël dhe qela, të dyja të skicuara dhe ndërtuara prej tij. Qela, një ngrehinë e stilit neoklasik, ka përfunduar në vitin 1906. Kisha, prej tri vjetësh e rikonstruktuar, duke respektuar me përpikmëri elementet arkitekturorë të objektit, të kohës kur qe ndërtuar, ngjan me cilëndo simotër të një fshati të Spanjës, Italisë a të Polonisë, ku poeti pat studiuar, po edhe të Austrisë, Kroacisë a Sllovenisë. Në patalogun përpara saj, parvjet është vendosur shtatorja e poetit dhe të trija së bashku tani kanë krijuar një unit arkitekturor mjaft estetik.



Shtatorja, një krijesë artistike shumë e realizuar, e lakmuar edhe për një shesh të Shkodrës a Tiranës, është vepër e mjeshtrit Sadik Spahija.

Zef Balaj, një emigrant i diasporës në New York ka qenë donatori i saj, porse shenja të tilla bamirësie, që mbajnë emrat e familjes Ukgjini dhe biznesmenit dhe intelektualit të njohur shkodran, Gjergj Leqejza, gjen në vitrazhet e kishës e në "ingredientë" të tjerë të objektit muzeal. Kurse qela, shtëpia e famullitarit, ka filluar të mbledhë reliket e poetit, ato pak të mbetura, që akoma gjenden. E fundjma ndër to, që ka mbërritur aty 4-5 muaj më parë është edhe tryeza-skrivani 100 vjeçare e poetit. Ndjesia dashamirëse, e fshehur me finesë por edhe me risk të madh, ka mundur ta shpëtojë objektin e vlerë prej betejave ateiste të zhbërjes e të zhbirjes së gjithçkaje të lidhur me fenë e me besimin dhe me bartësit e tij, të nisura në vitin 1966. (Si për ironi të fatit qe 100 vjetori i lindjes së poetit). Në vitet e fillimit të atij rrëmeti të madh ideologjik, tryeza është përcjellë nga Kukli, në një kënd të pluhurosur të muzeut të Shkodrës. Ka qenë, si duket e njëjta qasje me sjelljen e qëndrimin ndaj vetë poetit, emri i të cilit, përgjatë gjysmëshekullit të rrëgjimit të shkuar jetoi në terr-dritën, që i ofroi rrëgjimi. Diktatori e kish emërtuar "klerik popullor", për ta veçuar kështu prej zulmës që kish ndërmarrë e do të ndërmerre ndaj bashkëvëllezërve të tij, sigurisht vetëm si arsye



propagandistike për paranojën e tij.

Që tryeza të arrijë më së fundi në Kukël, aty ku qe vendosur në krye të herës me orenditë e tjera të qelës, një shekull më parë, është dashur një proces i gjatë këmbëngulje e ballafaqje , ecejake nga Muzeu i Shkodrës tek Ministria e Kulturës e Tiranës dhe nga kjo e fundit përsëri tek i pari, në itinerarin e një karshilleku të ndërsjellët absurd...Falë afeksionit dhe mirësisë së poetit të mirënjohur Visar Zhiti, ish ministrit afatshkurtër të Kulturës, tani ajo është aty. Së shpejti do të fillojë edhe rikonstruksioni i qelës, e cila , me ecje të mundimshme po tenton të kthehet në një muze, a më saktë në një kompleks muzeal- Mjeda.

Ky është motivi i fillesës së një peligrinazhi të përvitshëm në Kukël, që zë fill tre vjet më parë. Nismëtar është Dom Nikë Ukgjini, famullitari i atyshëm sot...Misionar edhe ai, pasionant i punëve të historisë dhe kulturës kombëtare, ashtu si pararendësi i tij gati një shekull më parë. Dom Nikë Ukgjini prift nga Kosova, i doktoruar për histori në Kroaci, për rreth njëzet vite, ka hulumtuar vlera historike e kulturore nëpër rrethinat shqiptare të Malit të Zi. Më pas në Malësinë e Madhe , në Hot , në Shkodër e kënde



pari, të njëjtën gjë bën. Ka botuar monografi historike, është producent, por edhe konsulent shkencor i shtatë a tetë filmave dokumentarë, në të cilët evokohen figurat e spikatura të kulturës dhe historisë sonë kombëtare. Buzuku, Bardhi, Budi, Bogdani, Jezuitët, ndër to dhe Mjeda si dhe mendimtarët e patriotët e shquar që dolën nga ai urdhër. Projekte të mrekullueshme, realizuar si attribute vetëm të një njeriu dhe me vullnesën e tij të mirë, ato do të ishin të lakmueshme për cilindo institucion serioz.

Po cilin institucion ?...

Fishta, një tjetër shkëmb dijeje e kulture i këtij kombi, në çastet e agonisë së fundit kur po kapte pragun e jetës tjetër të amshuar i thotë një bashkëvëllaut të vet françeskan: "Po des...ju tash keni me mendue për salikim, por edhe Kombi ka...për rreth meje"(At' Gjergj Fishta, *numër për kujtimuer*, Shkoder 1941). Ata ishin të vetëdijshëm për gjithçka bënë e dhanë nga vehtja për kombin...Kombi shqiptar, sot ka dy shtete, ka dy ministri të kulturës. Dy institucione që e kanë për detyrë parësore të mbështesin e të realizojnë projekte, që ridimensionojnë vlerat më të çmuara të historisë së kombit . Do t'i bënëin kështu nder vetes, kryesuesit e tyre. Që s'po duan t'ia bëjnë!

Marr nga gazeta: **Shekulli, E**  
Hënë, 3 shkurt 2014, f, 18-19



Alma Mile  
Tiranë

## PLURALIZMI I BESIMIT DHE KOMUNITETET FETARE NË SHQIPERI

**Giovanni Cimbalo boton studimin mbi besimin fetar te shqiptarët. Studiuesi italian: Përse në Shqipëri nuk ka konflikte ndërfaqetare. Përplasja e fesë me shtetin gjatë diktaturës komuniste dhe bisedimet e dështuara për kompromis. Raporti i ri që shteti komunist donte t'u impononte besimeve fetare. Negociatat e Mehmet Shehut me klerikët katolikë dhe pretendimi për miratimin e ipeshkvijve nga qeveria.**

**Giovanni Cimbalo**, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri*, botues "Naimi", Tiranë, 2013.

Si një vend i vogël, ku bashkëjetojnë shumë fe, që vazhdimisht merret si shembull i "tolerancës fetare", ku besimi në Zot është ndaluar për 50 vjet me radhë e sot është e vështirë ta kthesh atë si diçka të qenësishme, Shqipëria ka tërhequr vëmendjen e studiuesit italian, Giovanni Cimbalo. Nisur nga ky fakt kurioz, profesori i Universitetit të Bolonjës ka analizuar veçoritë e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare, për të zbuluar se ku i ka rrënjët bashkëjetesa paqësore mes feve, apo, thënë ndryshe, "toleranca". Ky hulumtim na vjen përmes librit "Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri", botuar nga shtëpia botuese "Naimi". "Një ndër arsyt që na shtyu t'i futemi këtij studimi, ishte nevoja për të hetuar e zbuluar arsyt që e mbajtën Shqipërinë larg konflikteve ndërfaqetare, në

një kohë kur trevat rreth saj, me përbërje etnike dhe fetare shumë të përafërt me të, nuk paqëtohen aq lehtësisht.

Edhe pse e drejta, si e tillë, qëndron mbi strukturat konkrete, në shumë raste ajo luan rol vendimtar për edukimin e bashkëjetesës, pasi është e aftë të konsolidojë në jetën e faktorëve të ndryshëm shoqërorë, sjellje dhe struktura që shkojnë e përcaktojnë drejtpërsëdrejti marrëdhëniet ekonomike dhe shoqërore", thotë studiuesi në hyrje të studimit të tij. Përtej perceptimeve apo shpjegimeve romantike të tipit "besa", "kanuni", "mikpritja", prof. Cimbalo e gjen sekretin tek infrastruktura ligjore. Një analizë krahasuese mes normave dhe ligjeve të miratuara prej fillimit të shtetit shqiptar, gjatë monarkisë, regjimit komunist deri më sot e ka lejuar autorin të depërtojë më thellë në historinë e këtij vendi, për të hedhur më shumë dritë mbi ndryshimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve institucionale mes komuniteteve fetare dhe shtetit; të kuptojë ç'ndikim ka pasur kjo në formimin e mendësisë mbi përkatësinë fetare dhe ç'trajtë ka sot ushtrimi dhe pjesëmarrja në jetën fetare.

Gjatë këtij shqyrtimi, autori vëren se ndër parimet e saj themelore Shqipëria ka ndarjen mes shtetit dhe fesë, laicitetin e institucioneve, e kryesisht, pluralizmin fetar. Këtij parimi, si tregon përmes dokumenteve autori, i janë referuar të gjithë udhëheqësit e shtetit shqiptar: nga Ismail Qemali, Fan Noli, Ahmed Zogu, Enver Hoxha, deri te lidërshipi aktual. Përmes dokumentesh Cimbalo tregon për marrëdhënien jo të thjeshtë mes shtetit dhe fesë, sidomos gjatë periudhës së diktaturës komuniste. Interesante janë faktet dhe dëshmitë që zbardhin raportet e politikës shqiptare me kryeqendrat botërore të fesë si Patriarkana dhe Vatikani, përpjekjet e





Ahmed Zogut dhe Enver Hoxhës në këtë drejtim. Ky i fundit u përpoq të shkëpusë kishën katolike nga Vatikani. Këtë moment në historinë e raporteve mes shtetit dhe kishës kemi shkëputur nga libri i Giovanni Cimbalo, “Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri”. Çfarë ndodhi në atë vit të largët 1949? Diskutimet që zgjatën për muaj me radhë me kishën katolike dhe përfaqësia e shtetit komunist me Mehmet Shehun në tryezën e bisedimeve.

### Pjesë nga libri

Mes komuniteteve fetare, ajo që kishte më së shumti probleme me paraqitjen e një statuti që t'u përgjigjej kriterëve të caktuar nga dekreti i vitit 1949, ishte pa dyshim Kisha Katolike, e cila faktikisht që në vitin 1929 e kishte refuzuar një gjë të tillë. Duhet kujtuar se gjëja e parë që i kërkohej ishte ndërprerja e marrëdhënieve me Selinë e Shenjtë, ose, së paku, nënshtrimi ndaj kontrollit të shtetit. Një ndërmarrje e tillë kishte pasoja të rënda për kryerjen e shërbimeve fetare, si për përpunimin, ashtu dhe zbatimin e doktrinës katolike, arsyeja që Kisha Katolike e kundërshtoi dekret-ligjin e ri dhe

gjatë një mbledhjeje të mbajtur në argjipeshkvinë e Shkodrës, në nëntor të vitit 1950, ku morën pjesë 56 përfaqësues të të gjitha besimeve, vendosën të ruanin varësinë ndaj Selisë së Shenjtë.

U kundërshtua modeli i statutit i parapërgatitur nga qeveria, gjë që e vuri shtetin shqiptar para një sfide të papritur dhe ndezi një konflikt të pazgjidhshëm. Shteti nuk mund t'i pranonte vendimet e Kishës Katolike, megjithatë nuk e përdori aty për aty, forcën dhe dhunën, pasi ishte i bindur që kleri përfaqësonte vullnetin e besimtarëve. Ta detyroje Kishën Katolike të pranonte skemën e statutit, do të thoshte të nxisje rrëmuje, të shtyje drejt dhunës një pjesë të besimtarëve katolikë shqiptarë, për të cilët Selia e Shenjtë ishte simbol mijëravjeçar i fesë. Për këtë arsye, shteti e ftoi Kishën Katolike të shtrohej në bisedime për arritjen e një marrëveshjeje që do t'i jepte zgjidhje konfliktit, por, në të njëjtën kohë, shihte si të bënte për vete, së paku, një pjesë të klerit. Kisha Katolike e pranoi ftesën e qeverisë për bashkëbisedime.

Delegacioni qeveritar drejtohej nga zëvendëskryeministri Mehmet Shehu, ndërsa ai katolik nga meshtari Bernard Shllaku, i cili deklaroi menjëherë se skema e statutit, sipas këtij ligji, ishte e papranueshme për katolikët. Bisedimet zgjatën thujse gjashtë muaj dhe u shoqëruan me debate të flakta, pasi secila palë këmbëngulte në arsyet e veta dhe nuk pranonte kompromise. Delegacioni qeveritar mendonte se statuti sanksiononte pavarësinë e Kishës Katolike shqiptare nga Selia e Shenjtë, ndërsa delegacioni katolik sillte argumentin që e gjithë bota katolike e njihte Papën si udhëheqës shpirtëror të krishterimit, prandaj propozimi ishte i papranueshëm. Nga ana tjetër, pala katolike jepte siguri që vazhdimi i lidhjes së Kishës Katolike shqiptare me Selinë e Shenjtë nuk do ta cenonte pavarësinë e shtetit shqiptar, pasi ajo merrej vetëm me anën shpirtërore dhe veprimtarinë e kultit. Përplasja konkrete ndodhi me emërimin e ipeshkvijve për dioqezat shqiptare. Delegacioni katolik këmbëngulte që emërimi i ipeshkvijve duhet bërë nga Selia e Shenjtë.

Mehmet Shehu hartoi këtë propozim në emër të qeverisë: delegacioni katolik mund të propozonte emrat e katër ipeshkvijve dhe këto, pasi të shqyrtoheshin dhe miratoheshin nga qeveria, t'i dërgoheshin për dijeni Selisë së Shenjtë. Selia e Shenjtë nuk e pranoi këtë propozim, pasi duhej të ishte ajo vetë dhe jo kleri shqiptar për t'ia përcjellë emrat qeverisë, në formë

GIOVANNI CIMBALO

## Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri

Studime të së drejtës së krahasuar.  
E DREJTA KISHTARE DHE E DREJTAT NJERËZORE.  
Raporti i fesë me shtetin në Shqipëri.





të rezervuar, siç ndodhte me vendet e tjera. Kjo binte ndesh me parimet hierarkike që karakterizojnë organizimin kishtar dhe që i kanë themelet në vetë natyrën e pontifikatit të Romës. Këmbëngulja e Kishës Katolike në qëndrimet e veta i bllokoi negociatat dhe kjo e ashpërsoi kundërpërgjigjen e qeverisë shqiptare.

Përplasja e qeverisë shqiptare me komunitetet fetare tashmë kishte marrë karakter të përgjithshëm dhe Enver Hoxha urdhëroi që “lufta” kundër tyre të zhvillohej në dy plane: së pari kundër klerikëve reaksionarë, e, së dyti, i duhej mëshuar edukimit ateist të popullsisë. Ai ishte i bindur që: “Drejtuesit e klerit nuk do të bëheshin kurrë miq të qeverisë dhe të partisë, ndërsa besimtarët janë miqtë tanë, por partia duhet të punojë ngadalë dhe me durim për çrrënjosjen e besimit ndaj zotave, fesë dhe kishës”. Me të marrë këto udhëzime, delegacioni qeveritar filloi të akuzonte hapur palën tjetër për veprime të kundërligjshme dhe kryetarin e delegacionit si bashkëpunëtor të fashizmit. Kjo bëri që delegacioni katolik të zbriste në kompromis: t’i mbante të fshehta lidhjet me Selinë e Shenjtë pa i bërë publike, por as kjo nuk ishte e mjaftueshme për delegacionin qeveritar, i cili i mbylli bisedimet me kërcënime ndaj Selisë së Shenjtë, duke e akuzuar edhe atë si bashkëpunëtor të fashizmit.

Delegacioni katolik u tërhoq nga negociatat për t’u konsultuar me bazën, mes anëtarëve të së cilës kishte mjaft pakënaqësi. Bernard Shllaku, edhe pse shumë i moshuar, pranoi të bënte hapin e parë për nënshkrimin e statutit, të hartuar sipas skemës së parapërgatitur nga qeveria, por u premtoi besimtarëve se do t’i mbante personalisht lidhjet me Selinë e Shenjtë. Statuti kufizonte autonominë organizuese të Kishës Katolike brenda vendit dhe ia kalonte kompetencat e Papës një organi të ri, Argjipeshkvisë së lartë katolike, me seli në Shkodër. Në të bënin pjesë të gjithë prelatët e lartë



të dioqezës shqiptare. Kryetar i komunitetit katolik bëhej argjipeshkvi i Shkodrës, i cili mund të vendoste për mbajtjen e marrëdhënieve me institucionet analoge jashtë vendit. Statuti i ri e lejonte Kishën Katolike të ruante të mirat e saj dhe të kryente funksionet e saj në vend.

### At Anton Harapi para gjyqit komunist

Sipas nenit 1 të statutit “Kisha katolike e Shqipërisë ka karakter kombëtar, është një person juridik dhe përfshin të gjithë besimtarët katolikë të Shqipërisë. Ajo frymëzohet nga parimet fetare të Kishës botërore Katolike, të themeluar prej Jezus Krishtit, nën drejtimin fetar të Papës, trashëgues i pushtetit të apostullit Pjetër. Ajo nuk mban me Papën asnjë lidhje të llojit organizues, ekonomik apo politik”. Ky nen përmbledh më së miri marrëveshjen e arritur dhe sanksionon parimin: Kisha katolike shqiptare ka karakter kombëtar, por sidoqoftë, besimtarëve katolikë shqiptarë u njihet e drejta të frymëzohen nga parimet e Kishës Katolike botërore.

Me dorëzimin e drejtimit të Kishës Katolike tek Argjipeshkvia e Shkodrës, që mbulonte funksionet më të larta të klerit, kësaj i lindte detyra të ruante të paprekur unitetin dogmatik, ligjet dhe traditat e Kishës Katolike të Shqipërisë: të drejtonte dhe administronte dioqezat; të përkujdesej për përgatitjen e klerit katolik nëpërmjet hapjes së seminareve, të cilët mund të ngriheshin dhe administroheshin në bazë të rregullores së miratuar nga Këshilli i Ministrave; të plotësonte bilancin e kishës dhe të administronte pasuritë e saj; të pranonte subvencionet e shtetit; të përkujdesej për botimin e letrave pastorale, të revistave dhe librave fetarë dhe për përgatitjen e klerit katolik, në përputhje me dogmat dhe ligjet e shenja dhe me legjislacionin e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Argjipeshkvi emëronte ipeshkvijtë dhe funksionarët e tjerë të lartë, të cilët miratoheshin nga Këshilli i Ministrave. Emërimi i ipeshkvijve dhe argjipeshkvijve të rinj bëhej në prani të argjipeshkvit apo ipeshkvit që autorizohet nga argjipeshkvi katolik shqiptar, në bazë të dogmave fetare, si dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave.

Procedura e emërimit të klerikëve shkaktoi përplasjen më të fortë mes shtetit shqiptar dhe Kishës Katolike, pasi qeveria këmbëngulte në fitimin e së drejtës për miratimin e emërimeve duke i lënë Selisë së Shenjtë vetëm “bekimin” për të përzgjedhurit nga Kisha shqiptare, duke e



konsideruar këtë të fundit një Kishë kombëtare që e caktonte hierarkinë e vet nëpërmjet zgjedhjeve. Nga ana tjetër, pala katolike nuk hiqte dorë nga lidhjet hierarkike dhe njihte vlefshmërinë e normave të së drejtës kanonike. Konflikti dukej pa zgjidhje, por qeveria ka të gjithë vullnetin për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, aq sa vendos t'u kërkojë ndihmë dhe këshillim "shokëve sovjetikë".

Me caktimin e qarqeve administrative mund të mbante lidhje me komunitetet fetare dhe institucionet shtetërore me seli jashtë vendit. Këto nuk mund të ishin marrëdhënie varësie dhe as nënshtrimi nga pikëpamja organizuese, ekonomike dhe politike, por bashkëpunuese lidhur me çështjet fetare dhe të ndiqnin kanalet zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 25 të dekretit për komunitetet fetare, nr. 743, datë 27/11/1949. Funksione të tilla zhvilloheshin edhe në bashkëpunim me pjesëmarrjen e vikarëve të përgjithshëm, të kancelarëve, të këshilltarëve dhe të zyrtarëve të tjerë të kancelarisë të zgjedhur prej ipeshkvit. Në vijim të statutit trajtoheshin famullitë dhe juridiksioni i tyre si dhe detyra e famullitarit i cili, ashtu si i gjithë kleri, duhej të mos martohej. Vëmendje e veçantë u kushtohej urdhrave rregulltarë për meshkuj dhe femra, e sidomos urdhrin françeskan që shihej si struktura më e qëndrueshme e Kishës Katolike në Shqipëri. Interes të veçantë paraqesin normat lidhur me financimin e kultit. Pasuria e kishës përbëhej nga të gjitha të mirat e argjipeshkvive dhe famullive dhe ndahej, ashtu si te komunitetet e tjera, në pasuri të kultit, ku përfshiheshin të mirat në shërbim të qëllimeve fetare dhe në pasuri të zakonshme, e cila

përbëhej nga të mirat materiale për mbajtjen e kishës, të personelit administrativ dhe shërbyes. Mbarështimi, shitja dhe administrimi i pasurisë fetare, kontrolli dhe verifikimi i tij, ashtu si për kultet e tjera, duhet të ishin në përputhje me dispozitat legjislative në fuqi, me rregulloren e posaçme mbi administrimin e pasurisë së Kishës Katolike të Shqipërisë (që pritej të hartohej) dhe me dispozitat e Këshillit të Ministrave. Shpenzimet për mbajtjen e kultit dhe kryerjen e shërbesave fetare duhej të hiqeshin me kontributin vullnetar të besimtarëve, të ardhurat nga pasuria e kishës dhe me subvencionet e shtetit. Shteti mbështeste pushtetin disiplinor të ipeshkvijve mbi klerin, përcaktonte ndarjen administrative, formën dhe strukturën e vulave. Statuti u hartua dhe

miratua në mbledhjen e përgjithshme të klerit katolik shqiptar, mbajtur më 26 qershor të vitit 1951, në Kurjen e Argjipeshkvisë metropolitane të Shkodrës, sipas parimeve dhe dispozitave të përgjithshme të së drejtës kanonike në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të dekretit mbi komunitetet fetare. Aty u përcaktua mënyra sipas së cilës Kisha katolike e Shqipërisë rregullon, drejton dhe administron çështjet e saj fetare dhe se statuti hyn në fuqi pas miratimit të Parlamentit të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Ndryshimet që bënë komunitetet fetare mbi statutet e tyre gjatë vitit 1950, edhe pse e kufizonin ndjeshëm veprimtarinë, u lejonin atyre të ruanin njëfarësoj të mirat e tyre. Është pikërisht kërcënimi i zhveshjes prej të gjitha të mirave, që e shtyn Kishën Katolike të Shqipërisë të hartojë statutin e vet dhe ky është një tregues i vërtetë i njohjes së qëndrueshmërisë së formave të reja të shtetit. Gjithsesi, jo më parë se me 3 gusht, qeveria botoi versionin e statutit të firmosur, tashmë në duart e saj dhe e paraqiti ngjarjen si një sukses të forcave progresiste të partisë komuniste dhe si mundje e forcave prapanike të klerit dhe të Kurjes romake. Kjo e shtyu komunitetin katolik shqiptar të mbronte qëndrimet e veta. Një pjesë e tij pohonte se ishte mashtruar dhe se teksti i statutit ishte modifikuar pa dijeninë e tyre. Të tjerë pohonin se një pjesë e klerit katolik kishte rënë në kompromis me qeverinë, nisur nga premtimi i Bernard Shllakut për t'i mbajtur personalisht lidhjet me Selinë e Shenjtë.

Tomë Mrijaj  
New York

## Martirja e Kosovës Marie Shllaku (1920-1946)

Strehimi në shtëpinë e Nikollë Mrijaj

*Para disa vitëve, kam botuar një libër monografik, kushtuar heroinës shqiptare të trojeve etnike, shkodranes Marie Shllaku. Sot, për lexuesit po ofroj disa kujtime të gjyshes dhe babait tim, të cilat zbardhen për herë të parë.*

Në mesin e shekullit XX Marie Shllaku, ishte femra e vetme shqiptare ndër 50 çetat nacionaliste, që vepronin me armë në dorë në Kosovë, me synim patriotik të bashkimit të trojeve shqiptare në një shtet të vetëm dhe në luftë të papajtueshme, kundër epidemisë së mortajës komuniste në trojet tona. Maria dhe Atdheu, ishin motra binjake të shpirtit dhe zemrës së saj.

Lidhur me qëndrimin e Marie Shllakut në shtëpinë tonë (gjatë kohës që Kryetar i Komunës në Zllakuqan ishte babai im), po risjell të freskët kujtimet e paharruara për sokoleshën e re sypatrembur, shkodranen dhe martiren liridashëse të Dardanisë.

Së pari, trimëresha patriote Marie Shllaku, në luftën e saj kishte si synim Shqipërinë Etnike, që është edhe thelbi kryesor i Lidhjes së Parë të Prizrenit (1878), të Dytë (Prizren, 1942) dhe të Tretë (1962, New York, ShBA), për të cilën s'ka nevojë të bëj koment.

Së dyti, qysh në moshën time të femijërisë, shumë herë e dëgjoja këtë emër në odën e burrave, në sofrat, që shtronte babai im për miqtë e ftuar ose vizitorë të rastit, që ishin të shpeshtë në shtëpinë tonë.

Më gjerësisht, për këtë personalitet të madh më tregoi gjyshja (lokja), se si ajo vajzë trime, kishte buajtur mëse një javë në shtëpinë tonë.

Me ardhjen në Kosovë të babait të saj, Mark Simonit nga Shkodra (i dërguar nga Qeveria komuniste dhe forcat e Sigurimit, që përndiqnin për t'i vrarë antikomunistët dhe nacionalistët e vërtetë asokohe, shënimi im T.M.), për t'ia mbushur mendjen vajzës së tij të re, që të heqë dorë nga rruga e saj patriotike, në male me çetat nacionaliste të Kosovës, kishte lindur ideja, që Maria të vinte në shtëpinë tonë, ku ishte më e sigurtë. Për më tepër Marku, i ishte drejtuar fratit të Pejës, At Benardin Llupi O.F.M. dhe ky e kishte dërguar tek frati i

K i s h ë s s ë  
Zllakuqanit, Patër  
Tomë Xhaja O.F.M.

Pader Toma, meqë misionari françeskan kishte lidhje të ngushtë me babain tim, si vend strehimi më të sigurtë dhe me besë shqiptare, kishte zgjedhur shtëpinë tonë. Po, kishte edhe një arsye tjetër.

Duke qenë, se babai punonte në administratën e pushtetit lokal, askush nuk mund të dyshonte, se në shtëpinë e tij, ai mbante një antikomuniste të përbetuar, të rregjimit kolonial sllavo-komunist serb dhe atë shqiptarë të vendlindjes, heroinën Marie Shllaku.

Një ditë - kujtonte gjyshja ime - Lekë Marleku, një mik mik i shtëpisë dhe burrë besnik e solli Marien nga malet e Dollcit (Lugu i Drinit), të veshur me teshat e nuses në shtëpinë tonë.

“Unë, -tregon gjyshja ime- fjeta në një dhomë me Marien, prandaj edhe ruaj shumë kujtime. Ishte një javë shumë e gjatë dhe e frikshme për mua, sepse nacionalistja shkodrane mbante me vetë armë, disa bomba dore, radio-lidhje dhe një bllok shënimesh (ditar).

Ajo ishte edhe shumë e bukur nga pamja dhe, tepër tërheqëse në biseda të lira. Gjatë natës, kur dëgjonim ndonjë të lehur qeni, ajo me armë në dorë vraponte drejt oborrit, papasur frikë.

Unë frikësohesha, se mos gjatë zgjimit të rrufeshëm të saj dhe daljes së shpejtë, me pushkë në dorë, drejt oborrit të shtëpisë (mes territ të natës), pa dashje do të haste në bombat e saj luftarake, të cilat, mund të shpërthenin nga çasti në çast.



Tomë Mrijaj



*Gjatë ditës, kur antarët e familjes gjendeshin në fushë, për t'u marrë me punët e përditshme të bujqësisë (në arat e mbjellura), ajo kalonte ditën duke biseduar me të atin e saj. Këto ishin vërtetë momente emocionuese dhe unë gëzohesha, kur i shihja tek bisedonin ngrohtësisht atë e bijë.*

*Askush nga familja e jonë, përveç meje dhe djalit tim Nikollës, nuk ka ditur, se kush ishin këto miq shumë të rëndësishëm, që qëndronin në shtëpinë tonë. Ditët kalonin shumë shpejt.*

*Nuk e harroj kurrë ditën e ndarjes mes babait dhe bijës së vet të re. Shumë lot derdhi shkodrani Mark Simoni, për bijën e tij. Maria, si burrëneshë malesh qëndroi e fortë, deri sa babai i saj u largua.*

*Vetëm atëherë kur qe larguar, duke menduar të atin, ajo filloi të qajë me dënësë aq shumë, sa që mendova se zemra do t'i dilte nga kraharori. Në mbrëmje, Lekë Marleku e mori Marinë dhe e dërgoi tek shokët e vet, në male...*

*Edhe më vonë, kam dëgjuar sërish dëshmi qendrese të fortë të çetave nacionaliste, të prirë nga luftatarët e vërtetë lirishtashës, ku, spikaste trimëresha Marie Shllaku.*

*Gjatë tërë jetës time, kam risjellë në kujtesë ditët e paharruara, që kalova me sokoleshën stoike, vendosmërinë e saj, për t'i luftuar pushtuesit e huaj shumëshekullorë serb në Dardani nga sëmundja vdekjeprurëse e komunizmit bolshevik (proletarë), që ishte përhapur, për fat të keq, si kancer, në të gjithë trojet arbërore në shekullin XX..."*

Dhe për herë të parë, këtë histori po e zbardhi me ngjarjen, që disa herë më ka treguar gjyshja. Nanë lokja fisnike e moshuar, kishte shumë besim tek unë edhe pse isha fëmijë.

Ju kujtoj, se i isha betuar babait tim, që një ditë do të shkruaja një monografi për Marie Shllakun dhe, mbas shumë dekadave këtu në Amerikë, ja ku është.

Shtëpia e jonë, ishte vatër e sigurtë e heroinës, Marie Shllaku, e cila qëndroi aty, e fshehur për një javë. Tek ajo, familja jonë shikonte një luftëtare të vendosur për bërë jetën fli për interesat e larta të Atdheut; "me ba deken si me le", sikurse ka thënë *Poeti Kombëtar*, At Gjergj Fishta O.F.M.

Ajo, qëndroi në krah të bashkëluftëtarëve të mirënjohur asokohe, si: Ndue Përlleshi, Ukë e Shaban Sadiku, Prof. Ymer Berisha e trima të tjerë, prandaj ajo nuk pranoi të shkonte me të atin.

Babai im, kishte lidhje miqësore me dy tribunët e luftës çlirimtare në Dukagjin: Sadik Ramën e Gjurgjevikut (1872-1944) dhe Zef Gjiododën (1878-1948), por ndihmoi edhe luftëtarët e mëvonshëm, si: Marie Shllakun, Ndue Përlleshin (1908-1949),

Ukë e Shaban Sadikun, Prof. Ymer Berishën (1912-1946), Qazim Bajraktarin, Alush Smajlin, Shaban Demën (1919-1948) etj.

### Flamuri kombëtar në kujtimet e mia

Për çdo shqiptar në Kosovë, që ishte nën zgjedhën e egër të kolonizatorëve barbarë serbë, shfaqja e flamurit të Gjergj Kastriotit, ishte një dëshirë dhe mall i papërshkruar.

Të gjithë ne e kemi të fiksuar historinë e lavdishme të simbolit tonë, për të cilin, gjatë shekujve, për liri dhe pavarësi, kanë dhënë jetën me qindra dhe mijëra martirë.



Për herë të parë, flamurin kombëtar e pashë në shtëpinë time në vitin 1958. Porsa hyra në dhomën e grave, në një cep të shtëpisë pashë gjyshen, që mbante në dorë një rubë të kuqe, të cilën ishte duke e larë dhe nga sytë e saj pashë lot dhimbjeje, me një pikëllim të thellë...

Në atë gjendje që ishte, unë iu afrova ngadalë, për ta qetësuar, por ajo vetëm qante... Iu afrova më shumë dhe gjyshja nisi të përshpërisë fjalët... që për momentin s'i kuptoja... Ajo fliste ngadalë dhe me një zë të ulët, dhe vaji i ishte bashkuar me përshpëritjen e lehtë, që vinte nga dhimbja e brendshme e shpirtit të trazuar...

Gjyshja, mes lotëve, që i rridhinin rrëke, tha: “E kisha amanet! E kisha amanet!” E pyeta gjyshën, se për çfarë amaneti e kishte fjalën?! Ajo ashtu e përbotur m'u drejtua me flamurin, që e mbante shtrënguar në duar: “Bir, e kisha amanet nga ajo e gjorë e mjerë, që sot nuk i dihet as varri....”

Sërisht e pyes, se për cilën e kishte fjalën. Ajo m'u përgjigj: “Marie Shllaku!”

Po kush është Maria, vijova ta pyes sërisht gjyshën. Ajo, pasi më hodhi një vështrim të butë në sy, nisi të flasë me zërin e saj që i dilte me vështirësi, por e sigurtë për gjithçka thoshte, sepse kishte përjetuar histori të dhimbshme gjatë jetës së saj.

“Bir im, -vijoi gjyshja- Marie Shllaku, ka bujt mase një javë si mike speciale në shpinë tonë, ku, frati i Pejës At Benardin Llupi O.F.M., e kishte drejtue babën e saj Mark Simon Shllakun tek Pader Tom Xhaja O.F.M. e ky i fundit i kishte sugjerue të vinte në shpinë tonë, mbasi këtu ishte ma i sigurt takimi mes babës e bijës. N'at kohë Qeveria komuniste e Enver Hoxhës e kishte dërgue Mark Simon Shllakun, që t'a bindë vajzën e vet të kthehet n'Shqipni.

Bir i dashtun! Babi yt Nikolla, ishte njeriu ma i besueshem tek drejtuesit e çetave nacionaliste t'malit. Ata ia besuen edhe takimin e babës me të bijën në shtëpin tonë. Mbas një jave qëndrimi të Markut me vajzën, ai nuk mundi t'ia mbushë mendjen asaj të kthehet në vendlindje... dhe babë e bij, u ndanë atë ditë me lot nder sy...”

### Marije Shllaku, në Luftën e Drenicës

Gjatë hulumtimeve të mia, për të shkruar librin jetëshkrimor: *Marie Shllaku bijë e Shkodrës martire e Kosovës* (New York, 2004), kam ndeshur një shkrim shumë interesant, shkruar nga miku im Profesor Zef V. Nekaj (1919-2003), me pseudonimin *Kosovari*.

Autori, me banim në Kaliforni, e botoi shkrimin në numërin e parë të revistës fetaro-kulturore “Jeta Katholike Shqiptare” (New York, 1966), me titull: “*Marije Shllaku, martire shkodrane në Luftën e Drenicës*” (Viti I, No.3, 1966, f.22-23), ku, ndër të tjera, shkruan se:

“Gjatë gjithë dimërit 1944-1945, ajo u gjet aty, ku shkoi gjaku deri ne gju. Në pranverën e vjetit 1945, ajo ishte në mes t'Kryengritjes së Drenicës, me trimin e


pamposhtun Shaban Polluzhën n'krye. Kur kjo kryengritje u shue nga ushtrit e panumërta titiste, të përqendrome n'Kosovë nga të gjitha anët e Jugosllavis, Marije Shllaku qëndron n'llogoret e fundit pa e molisë as tymi as flaka, as uria e as t'fotit.

Ajo vendos m'u shkri dhe mos me u dorëzue. Por fati nuk i qeshë, sepse gjashtë plumba ia bajnë trupin shoshë dhe e sakatojnë krahësh e këmbësh.

Me të gjithë shokët e vramë, ashtu e plagosun, ajo s'qe ma në gjendje as t'ia merrte shpirtin vetes dhe u kap ende gjallë, por pa ndjenja...

Dy javët e fundit, Marijes i erdhi një afsh me u shfry në kangë, sa që të gjithë të burgosurit tjerë, o kujtoheshin se po del mendsh ose se kishte marrë ndonji lajm tinëz e po e falin, mbasi ishte vajzë.

Por Marija, i qetësonte me këto fjalë: “Edhe 'kaq' ditë e po martohem, prandej po këndoj, e këndon edhe ju kosovarë, se kurr s'ka marrë Kosova nuse shkodrane ma kangëtare se sa mue!”...”



**Dom Nikë Ukgjini**  
Shkodër

## Austro-hungaria dhe veprimtaria atdhetare e klerit katolik

**Qendra e Studimeve Albanologjike, më 26. Shtator 2013, në Akademinë e Shkencave në Tiranë, promovoi librin, *Shqipëri-Austri, Reflektim historiografik*, Botimet Albanologjike, Tiranë 2013.**


Në shek. XVI, shtetet dhe koalicionet, në Ballkan dhe në Evropë, konceptoheshin pos në baza nacionale edhe sipas përkatësive fetare. Dukuri kjo shoqërore, që në mesjetën e hershme.

Shtetet si Austria, Franca, Polonia, Venediku, Spanja, historikisht kishin qëndruar besnikë, fronit papnor të Romës, ku kjo e fundit, në të gjitha format e mundshme gëzonte përkrahjen nga këto shtete katolike. Nga ana e saj, Rusia, më kryeqendrën Moskën, duke u identifikuar me *Romën e tretë*, së bashku me aleatët, luante rolin e mbrojtësit të Bizantit dhe të besimit të ortodoksisë. Ndërsa, koalicioni osman i udhëhequr nga Turqia, kishte marrë përsipër të përhapte besimin islam, dhe në emrin e tij synonte pushtimin e gjithë Evropës së krishterë.

Austria në sajë të betejave të suksesshme të zhvilluara kundër Perandorisë Osmane gjatë shekullit të XVII, arriti të realizojë marrëveshjen e Beogradit të vitit 1739, me ç'rast filloi të ushtroj në tërë Perandorin Osmane evropiane të drejtën e Protektoratit për Kishën Katolike. Dhe me Paqen e dytë të Sistovcit, më 1791, në mes Perandorisë Austriake- dhe saj osmane, shënohet zgjerimin e këtij privilegjii fetar.

Austria perandorake, duke u bërë shefitare me tokat shqiptare që ndodheshin nën pushtimin osman, e shtoi interesimin e drejtpërdrejtë ndaj popullsisë katolike dhe popullit shqiptar në përgjithësi. Duke ushtruar të drejtën të zgjerimit të privilegjeve, me Paqen e lartpërmendur, ndërmoi hapat për hapjen e konsullatave në qendrat më të njohura shqiptare si: në Shkodër, Durrës, me vonë, në Vlorë, Janinë, Prevezë e Prizren.

Por, zotërimet veneciane, e franceze, ndaj katolikeve në trevat shqiptare, nga Froni Papnor do



i kalonin në mënyrë zyrtare Vjenës., tek me rastin e vizitës së ipeshkvit të Shkodrës, Imzot Benjanin Albertinit, në Romë në vitin 1836 dhe vizitës së tij në Vjenë tek perandori Austriak, Franc Jozef i I. Si rezultat i këtij takimi që dekreti i Vatikanit në vitin 1837, ku Perandoria danubiane, do ngarkohej, zyrtarisht me të drejtën e Protokultit, për t'u kujdesur për Kishën katolike në trevat shqiptare.

Papati, duke vlerësuar përkushtimin e Monarkisë, rreth çështjeve fetaro-kulturore dhe të atyre politike, marrëdhëniet diplomatike me Vjenën i ngriti, në rangun e Konkordatit, duke nënshkruar, marrëveshjen mbi protokultin në Romë me 18 gusht të vitit 1855. Konkordati në fjalë, shoqërohej me një, kapitull, "Articulus Secretus", prej 10 nenesh dhe kontraktonte mbështetjen e një "Program Veprimi" (Ballhausplatz) i cili, në emër të Selisë së Shenjtë, do të mbikëqyrej nga Kongregata, "Propaganda Fide" në Romë. Ndërlidhjet diplomatike, me Romen, do zhvilloheshin, nëpërmjet Nuncit Apostolik në Vjenë, Ambasadorit të Perandorisë Austriake në Romë, Konsullatës në Shkodër si dhe nga Patriarku i Armeneve në Kostandinopojë.

Konkordati rreth Protektoratit të Kultit i vitit 1855, i mbështetur në marrëveshjen e më pasme të vitit 1837, nënshkruar nga Imzot Benjanin Albertinit në Vjenë, përmbante në mënyrë indirekte disa të drejta të rëndësishme edhe për shqiptarët e besimit katolik.

Marrëveshjet e nënshkruara, filluan në të gjitha trevat shqiptare të gjallëroheshin në fillim të shek. XIX, me ndërtimin i objekteve fetare, shkollimin klerit brenda dhe jashtë vendit, ndërtimin e kolegjeve, hapjen e shkollave laike



shqipe të cilat i frekuentonin të tre besimet, botimin i librave etj.. Hapësira e ndikimit të Austro-Hungarisë në kuadrin e protektoratit, shtrihej në kryedioqezat: Tivar, Durrës, Shkup, dhe dioqezat: Shkodër, Sapë, Lezhë, Pult e Abacinë e Mirditës.

Ndryshime të theksuara në gjeopolitikën evropiane dhe atë ballkanike ndodhën, më 29 maj të vitit 1867, me formimin e Perandorisë Dualiste, austro-hungareze, të quajtur *Ausgleich* (kompromis), sipas të cilit Dhoma Austriake e Habsburgut ra dakord për të ndarë pushtetin me qeverinë hungareze. Si rezultat i këtij bashkimi jetëgjatë (deri në vitin 1918), Qeveria dualiste arriti të jetë njëra nga tre fuqitë më të mëdha të Evropës.

Në fillim të shek. XIX, pas luftërave të njëpasnjëshme, me Rusinë cariste dhe me Austrinë, Perandoria Osmane, në masë të madhe ishte dobësuar, për pasojë solli dhe krizën në sistemin e drejtimit ushtarak turk. Kriza e sistemit osman, në Shqipëri solli ndryshime pozitive dhe të rëndësishme në fushën ushtarake dhe politike të pashallëqet shqiptare, të cilat gjithnjë pavarësoheshin nga Porta e Lart.

Në jug të Shqipërisë, krishterimi ortodoks, edhe përkundrejt islamizimit të një pjese, ishte bërë element tejet përcaktues në jetën e përditshme të popullsisë dhe politikës ballkanike, për shkak të ortodoksisë, Ruse e Greke, të shpallura mbrojtëse e këtij besimi dhe në intervale kundërshtar të Perandorisë Osmane.

Austro-Hungaria, duke u mbështetur në realitetin politik dhe atë fetar, forcat e veta politike i kishte përqendruar në veri të Shqipërisë, në Shkodër, ku si qellim kishte për të ndihmuar shqiptarët kundër Perandorisë Osmane dhe si kundërpeshë ndaj sllavizmit dhe zbrapsje e Malit të Zi dhe Serbisë nga Shqipëria.

Trajtimi i shqiptarëve të islamizuar, nga Porta e Lart, si popullsi turke, pati pasoja të rënda për shqiptarët në Kongresin e Berlinit të vitit 1878, i cili kishte marrë përsipër, të hartonte në bazë të kombësisë, një hartë të re politike të Ballkanit. Në Kongres, duke i identifikuar shqiptarët të islamizuar në masën 70 % me turqit, një pjesë e madhe e tokave shqiptare nën Perandorinë Osmane, edhe përkundej kundërshtimeve të Austro-Hungarisë, u bënë plaçkë tregu ndërmjet shteteve fqinjë: Greqisë, Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi.

Mirëpo, edhe përkundrejt ngjarjes në Kongresin e Berlinit, përçarjeve, persekutimeve, intrigave të inskenuara nga Perandoria Osmane, shqiptarët e të tria besimeve, gjenin forcën e duhur,

për tu mobilizuar në mbrojtjen e çështjes kombëtare.

Formimi i shteteve ballkanike në baze kombësie, në gjysmë dytë shekullit të XIX, dhe shtimi i terrorit osman ndaj Veriut të Shqipërisë, kishte nxitur klerikët katolikë të ndërmarr në veri të vendit, një varg aksionesh të armatosura dhe luftëra të përgjakura për çlirimin e vendit.

Në këto momente jetike për popullin tonë, në mesin e atyre të cilët, krahas veprimtarive të tyre letrare, përkrahnin qëndresën e popullit kundër Perandorisë Osmane, ishin figurat e spikatura klerikale dhe letrare si: Abbat Preng Doçi, Imzot Jak Sarreqi, Imzot Pren Bianku, Imzot Lazer Mjeda, Dom Ndoc Nikaj, Dom Nikollë Kaçorri, poeti Ndre Mjeda, Dom Dod Koleci, Atë Gjergj Fishta, Atë Pal Dodaj e shumë të tjerë. Kleri katolik me angazhimin e tyre, krahas furnizimit me ndihma materiale për popullin e uritur, kishte arritur të ngrinin çështjen fetare e kombëtare në tryezat e diplomacisë evropiane.

Rol të pazëvendësueshëm në organizimin e kryengritjeve të shqiptarëve në prag të pavarësisë (vitet 1893-1912), dhe futjen e çështjes shqiptare në agjentin e Konferencave ndërkombëtare, kishte avokati i ynë i përhershëm Perandoria Austro-Hungareze.

Shtirja territoriale e shtetit të ri shqiptar të vitit 1912, që u njoh nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 1913, ishte rezultat i angazhimit të diplomacisë së Vjenës, dhe aleatit të saj Romes si qendër e katolicizmit në botë e cila frymëzonte klerin në angazhimin e tyre Për Zot, Atme e Përparim.

Nën Protektoratin e Kultit (Program Veprimi, - Ballhausplatz-in), përveç ndihmesës së çmuar dhënë për organizimin e kryengritjeve - çka solli edhe shpalljen e Pavarësisë - ajo që ofruar dhe në zhvillimin e ndërgjegjes sonë kombëtare, duke ndihmuar në fushën edukimit, arsimimit, botimit të librave shkollorë, revistave, ndërtimit të objekteve fetare, shkollave e shumë të tjera, madje, në mënyrë permanente, deri në vitin 1918.

Jam i bindur se mbajtja dhe botimi i kumtesave të dy Konferencave Shkencor, janë një rast i rëndësishëm i dokumentimit, për rolin e madh dhe lidhjeve historike e shpirtërore të dy popujve si dhe do shërbejë në forcimin e mëtejshme të miqësisë në mes dy popujve dhe udhëtimit të shqiptarëve drejt Evropës së bashkuar.

Marr nga gazeta: *Shqipatryja.com*,  
E Diel, 29 shtator 2013, (Suplement, Rindasi)

# KTHEU O ZOJA E KËSHILLIT TE MIRË

## “Zoja e Shkodrës” apo “Teqeje bektashinjsh”



Shenjtorja e Zojës së Shkodrës - 1932

Fondi: Fra Landi

Nga brezi në brez besimtarët katolikë kanë mbajtur gjallë bindjen në "mrekullinë" e datës 25 prill 1467; këtë ditë figura e Zojës që gjendej në afresk në një mur të Kishës në fjalë u shkoq prej vendit dhe, e ndjekur prej dy katolikëve shkodranë, të të quajturve De Giorgio e De Sklavis, shkoi e zuri vend në Kishën e Genazzanos.

Me nismën e klerit katolik të vendit, në vitin 1932, u pat organizuar një pelegrinazh për duke vizituar figurën e Zojës në Itali. Popullata katolike e Shkodrës duke pasur bindje të plotë në translacionin e Zojës, nuk ngurroi t'i përgjigje nismës së klerit-për të shkuar në Romë me marrë bekimin e Atit të Shenjtë edhe për t'i bërë homazhet e duhura kësaj figure. Shkodranët qenë të veshur e të mbathur me kostumet kombëtare të qytetit dhe rretheve me një larmi tërheqëse ngjyrash. Qindra e qindra persona, mbas një udhëtimi në det, arritën në Itali duke ju drejtuar Kishës së Genazzanos afër Romës. Atje të përmalluar me figurën e Zojës së Papërlyeme, e cila qindra vjet kishte mbetur larg trojeve shqiptare, pas pushtimeve osmane. Ajo Kishë edhe sot quhet Kisha e “Zojës së Këshillit të Mirë” (Madre del Buon Consiglio) dhe është gjithnjë nën kujdestarinë e etërve Augustinian. Konferenca Ipeshkvore Shqiptare, në Kincilin e III-të të Arbrit të mbajtur në vitin 1895 në Shkodër, shpalli Zojën e Shkodrës "Pajtore të Shqipërisë".

Në Kishën e Zojës së Shkodrës është varrosur Arqipeshkvi i Shkodrës, Mons. Jakë Serreqi, i cili vdiq në vitin 1922. Ai qe varrosur këtu për meritën që pat vu gurin e parë të ndërtimit të kësaj Kise me datën 25 Mars 1917. Kisha kishte përfunduar në vitin 1932, për të qenë shkatërruar nga sistemi komunist në vitin 1967. Pas viteve të pluralizmit politik u inauguruar në vitin 1998.

Shqiptaret katolikë e myslimanë, pas viteve 1900, janë "grindur" për 15 vite me radhe, për përkatësinë e truallit të kësaj Kise. Jusuf Efendi Golemi dhe Shan Deda, dy emra të vetëm që u bënë publikë si anëtarë të komisionit dypalësh, për bashkëqytetarët e tyre zgjodhën një të mesme të artë: katolikët mund të luteshin pranë këtyre rrënojave duke e konsideruar atë Kishë, ashtu sikurse dhe myslimanët mund të kryenin ritet e tyre fetare njësoj si në një teqe bektashinjsh. Pas verifikimi të çështjes nga komisioni Austro-Hungarezë, në vitin 1917. Pat nis puna në rindërtimin e Kishës së “Zonjës së Këshillit të Mirë”.



# VITRINË LIBRI



Giovanni Cimbalo

**PLURALIZMI I BESIMIT  
DHE KOMUNITETET FETARE  
NË SHQIPËRI**


*Naimi, Tiranë 2013*



Matteo Mandala

**LEKË MATRANGA**

*Ombra GVG  
Tiranë, 2012*



Don Pren Kola

**KREMTIMI MESHËS**

*Drita, Prizren 2013*

## **KUMBONA E SË DIELËS**

revistë fetaro-kulturore dymujore  
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë  
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: [n\\_ukgjini@yahoo.it](mailto:n_ukgjini@yahoo.it)

Web page: [www.kishakatolikeshkoder.com](http://www.kishakatolikeshkoder.com)

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,  
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

## **KUMBONA E SË DIELËS**

**Viti XXIX, nr. 1/2 (460-461) Janar - Shkurt 2014**